

EMANCIPIMI...



Ishte dhe vazhdon të ekzistojë dukuria e varësisë së njerëzve te disa njerëz. Njeriu është i krijuar asisoj që të synojë kënaqjen e atyre që i ka përreth dhe në këtë nuk ka ndonjë vërejtje nëse për të paguan çmim të logjikshëm. Porse, shfrytëzimi i kësaj natyrshmërie për të shkelë urdhrat e Krijuesit të natyrës nuk duhet lejuar nga askush dhe për askënd. Feja jonë atë e ndalon, prandaj një ndër qëllimet kryesore të Allahut me dërgimin e profetëve ishte fisnikërimi i atyre që do t'i binden Allahut dhe profetëve duke i çliruar nga robëria e njerëzve drejt robërisë së Allahut, robëri e cila është nder dhe privilegj sepse Allahu nuk ka nevojë të shfaqë forcën e as pushtetin e Tij mbi ata robër sepse ajo është e pakontestueshme nga të gjithë, prandaj nëse gjen rrugën të bëhesh rob i Tij, atëherë vërtetë je nderuar dhe privilegjuar.

Ashtu duhet të jetë thirrja e jonë ndaj njerëzve dhe jo e kundërta, siç dëgjojmë shpesh trumbetimin rreth emancipimit të femrës, gjegjësisht çlirimit të saj nga varësia e dikujt a diçkaje. Po! Gjithsecili besimtar e besimtare duhet të jetë i çliruar nga varësia e kujt do dhe çfarëdo nga krijesat, porse qëllimi i atyre është krejtësisht i kundërt, ata duan ta çlirojnë femrën nga imani që është bindja e saj, nga turpi që është bukuria e saj, nga nderi që është siguria e saj dhe nga mbulesa që është krenaria e saj. I keni dëgjuar të thonë “femrat kanë përparësi” por kjo vetëm para ndonjë hyrje-dalje për të gjetur rastin ta shfryjnë eposhin e shikimit, për ta parë trupin e asaj femre nga këmba e deri në kokë si dhe mënyra tjera të ulëta ndërsa “përparësitë” tjera që po i shohim duken të jenë formalitete aq bajate sa që herahershëm shihen qartë se nuk janë të sigjerta. Mjafton të vëresh hallin e atyre që u mashtruan pas këtij far emancipimi dhe do të gjesh një botë plot brenga, pa dashuri që zgjatë, pa fëmijë që respektojnë, pa nipa e mbesa që dëgjojnë dhe pa xhenet që ofron kënaqësi përgjithmonë.

Emancipimi i drejtë është kuptimi i rrugës së vërtetë dhe ndjekja e saj me guxim, krenari dhe pa asnjë frikë nga dushmanët e llojllojshëm.

Edhe ajo që muajin e kaluar ndodhi në Tunizi, po ndodhë ende në Egjipt e ndoshta edhe në Algjeri, madje ndoshta edhe në vende tjera nga bota arabe mund të jetë emancipim dhe çlirim nga varësia e diktatorëve të paskrupullt që deri sot keqpërdorën durimin dhe butësinë e popullatës islame. Uroj që këtë emancipim të mos e prishë faktori ndërkombëtar që “ka frikën se në ato vende nuk do të gjykojë demokracia” ndërsa deri sot nuk shihnin përdhosjen e miliona njerëzve në ato vende. Besoj se ato vende kanë koka të ndritura dhe dijetarë që shumë mirë dinë ta emancipojnë popullin e vet, me brengat e të cilit janë lindur, rritur, po mplaken ndërsa shumë prej tyre kanë vdekur.

Allahu na ndihmoftë të gjithëve.

Në emër të redaksisë: Omer Berisha

AKTUALE

- 3-6** | RETROSPEKTIVË MBI ÇËSHTJEN E HIXHABIT NË SHQIPËRI
7-9 | TUNIZIA... PËRFUNDIMI I NJË SHEJTANI TRONDIT KARRIGET E TË TJERËVE
10-11 | DHJETË DITË QË TRONDITËN TIRANËN
12-14 | BLIC LAJME

SFIDA

- 15-17** | BETEJA E PAPËRFUNDUAR KUNDËR HIXHABIT

DRITARE

- 18-20** | ROBËRIT E PASIONEVE
21-23 | FETVAJA DHE LIRIA

FIKH

- 24-28** | MBULESA ËSHTË FARZ

EKONOMI

- 28-30** | INVESTIMI NË ISLAM

FAMILJA

- 31-34** | HIXHABI — AKTI I BINDJES
35-37 | GRUAJA, FAMILJA DHE EKUILIBRI I RËNDË

TEFSIR

- 38-41** | HIXHABI I DALLOI BESIMTARET E LIRA PREJ ROBËRESHAVE

HADITH

- 42-45** | LUTE ALLAHUN TË MOS ZBULOHEM

THESARE

- 46-50** | PSIKOLOGJIA E NJERËZVE TË RËNDOMTË

FETVA DHE KONSULTIME

- 51-55** | KA VËSHTIRËSI SOCIALE DHE MENDON TA HEQ HIXHABIN...]

BOTA ISLAME

- 56-60** | REPUBLIKA E TUNIZISË

REDAKSIA

Kryeredaktor: Omer BERISHA

zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI

Anëtarë të redaksisë:

Ismail BARDHOSHI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI,
Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA, Rashit ZYLFIU dhe Hajrush MANI

Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA

Redaktor gjuhësor: Roald HYSA

Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)

Boton: AlbIslam

Adresa: rr. Petre Georgiev nr. 63 | Çair | Shkup 1000
e-mail:

albislam@albislam.com

albislam@gmail.com

sms: +389 71 806 114 | fax&tel: +389 2 26 12 932

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denarë)

xhirollogaria: 0270100245547

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro etj.)

Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T.: KOBSMK2X

IBAN: MK07300701002455425

numri tatimor: 4030008038784



RETROSPEKTIVË MBI ÇËSHTJEN E HIXHABIT NË SHQIPËRI

Shkolla e mesme Qibrie Ciu dhe Andon Z. Çajupi në kryeqytet, në vitin 1994 do të ishin institucionet e para arsimore, ato që do të vinin para zgjedhjes vajzat e para me shami: ose shaminë dhe jashtë shkolle, ose në shkollë dhe pa shami! Shkolla është laike! Refren ky që do të përsëritet për gati njëzet vjet edhe në kohën që po shkruajmë këto rreshta.

SHKRUAN: JUSTINIAN TOPULLI

Që në fillim të këtyre rreshtave më duhet të pohoj, se një këndvështrim historik mbi ngjarjet që kanë të bëjnë me problemin e mbulesës islame në shkollat publike në shtetin shqiptar kërkon një studim të mirëfilltë hulumtues. Njëzet vjet jetë e një populli nuk janë pak,

por për të shkruar historinë e këtyre njëzet viteve duhen akoma vite të tjera, për të reflektuar mbi ato që kanë ndodhur dhe po ndodhin. Cikli i historisë dhe i epokës së një brezi akoma nuk është mbyllur dhe koha ka rezervuar për të akoma ngjarje, pa të cilat nuk do të mund të plotësohej kuadri i plotë i kësaj periudhe tepër dinamike të këtij populli.

Problemi i shamisë së femrës muslimane padyshim duhet parë në kompleksitetin e ndryshimeve shoqërore që pësoi shoqëria shqiptare pas rënies fizike të sistemit komunist dhe meqë ky proces është akoma i papërfunduar është e vështirë, që për çështjen në fjalë të japim një panoramë të plotë dhe përfundimtare.

Gjithsesi çështja e shamisë, edhe pse ajo lidhet dukshëm më së shumti me mbartjen e saj nëpër shkolla, është më e gjerë dhe ka të bëjë me vetë fenomenin e rikthimit të kësaj norme islame në mbarë hapësirën publike të shoqërisë shqiptare. Vitet '90 do të ishin vitet e para të rilindjes së jetës fetare në Shqipëri bashkë me ardhjen e literaturës dhe predikimit islam në vend, tek ne do të rikthehej edhe veshja islame për vajzat dhe gratë muslimane. Ishte e natyrshme, që kjo gjë pas kaq vitesh privimi të bënte përshtypje te njerëzit, që ishin edukuar me frymën e njeriut të ri socialist. Në ato vite krahas shamisë do të shikoje edhe djem me flokë të gjata, mustaqe dhe mjekra të parruara, me qëllime aspak fetare, veshje që deri dje ishin të ndaluara, si dhe shumë shfaqje të tjera, të cilat më parë konsideroheshin, si shfaqje të huaja të një morali dekadent perëndimor, por këto shfaqje edhe pse të vështira nga një pjesë për t'u pranuar ishin më se të kuptueshme dhe të tolerueshme, sepse ato i përkisnin të drejtave dhe lirive të njeriut, e që kishin të bënin pikërisht me dokumentin e parë që shteti komunist në agoninë e tij nënshkroi në Helsinki. Ndërsa për çudi shamia islame dukej sikur nuk bënte pjesë akoma në këto të drejta dhe liri! Dukej se shqiptarët kanë qenë të privuar vetëm për t'u zhveshur më shumë seç u lejonte shteti komunist, por jo edhe për t'u mbuluar më shumë, se çfarë ai konsideronte si normë veshje! Kështu pra, ndërsa porta e lirisë u hap në njërin krah,

“Në ato vite krahas shamisë do të shikoje edhe djem me flokë të gjata, mustaqe dhe mjekra të parruara, me qëllime aspak fetare, veshje që deri dje ishin të ndaluara...”

atë të liberalizmit, krahu i konservatorizmit dhe kthimit tek traditat fetare vazhdonte të ishte pjesërisht i mbyllur. Në rrugët e Tiranës, kur për herë të parë u shfaqën vajzat muslimane me shami, ato bënë më shumë përshtypje sesa simotrat e tyre, të cilat dita-ditës ekspozonin gjithmonë edhe më shumë trupin e tyre femëror, ndoshta edhe për shkak të kësaj të fundit. Mirëpo shteti komunist në rrugë e kishte humbur fuqinë, ndërsa në mentalitetin e shumë njerëzve akoma jo. Vajzat me shami veç përballjes me opinion familjar dhe atë shoqëror, u duhej të përballeshin edhe me një opinion më të ashpër, atë institucional arsimor. Shkolla e mesme Qibrie Ciu dhe Andon Z. Çajupi në kryeqytet, në vitin 1994 do të ishin institucionet e para arsimore, ato që do të vinin para zgjedhjes vajzat e para me shami: ose shaminë dhe jashtë shkolle, ose në shkollë dhe pa shami! Shkolla është laike! Refren ky që do të përsëritet për gati njëzet vjet edhe në kohën që po shkruajmë këto rreshta. Ne akoma nuk e dimë nëse për të ka ardhur momenti të meket apo jehona e tij do të vazhdojë të na ndjek pas edhe për vite të tjera. Ky ishte vetëm fillimi, një fillim i padukshëm për të cilin pak-kush di seç ndodhi, për të vazhduar me raste të tjera të padukshme, të cilat do të bënin jehonë më së fundi në botën e

medieve në vitin 2001, kur tre vajza muslimane në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja në Tiranë do të refuzonin t'i bindeshin drejtorit për të bërë zgjedhjen tashmë të njohur: ose shkollën, ose shaminë! Çështja u bë objekt i një polemike publike, si asnjëherë më parë, madje për herë të parë ajo tentoi të marrë rrugën e zgjidhjes juridike, e cila dukej se ishte në krah të zgjidhjes në favor të shamisë, por ngeci! Ç'kishte ndodhur? A ishin akoma muslimanët e rinj shqiptarë të papjekur dhe të paorganizuar për ta mbrojtur dhe për ta fituar atë betejë? Ndoshta po! Apo ishte shoqëria shqiptare dhe institucionet shtetërore ato që në të vërtetë vuanin akoma nga mentaliteti i regjimit të shkuar dhe nga dehja e atij që erdhi? Ka gjasa që të jenë të dyja. Kjo edhe për shkak se në mesin e vetë muslimanëve pati zëra, që nuk ishin të gatshëm t'i shkonin deri në fund kësaj çështje, pasi për ta vajzat muslimane nuk duhet të përziheshin me gjininë tjetër, në një shkollë ku të dyja gjinitë zhvillojnë mësimin në të njëjtin ambient. Edhe pse ky argument dukej disi i çuditshëm për rrethanat në të cilat jetonin këto vajza dhe mbarë shoqëria shqiptare, që nuk ishte aspak çudi që vetë shkolla, në një mënyrë ose një tjetër të ishte një nga arsyet pse ato kishin vënë shaminë dhe e mbanin atë, ai arriti të bëhej një ngërç në zgjidhjen juridike të këtij problemi.

Viti 2007 do të regjistronte rastin e parë mediatik të ndalimit të shamisë, tashmë jo në shkollë të mesme, por në një universitetet, atë të Durrësit. Deri në këtë vit vajzat me shami nëpër universitete nuk ishin ndaluar, pasi edhe vetë liria nëpër këto institucione është më e madhe, edhe pse ato tek-tuk kanë hasur në probleme nga mësimdhënës të ndryshëm, apo nga fotot e tyre me shami në dokumentet e

“Muslimanët e Shqipërisë si asnjëherë më parë, në nivel individual dhe kolektiv, në rang organizatash dhe personash, lëshuan një rrebesh reagimesh, që kërkonin mbrojtjen e kësaj të drejte...”

diplomimit. Por ky rast duket se do të zgjidhej politikisht, me ndërhyrje nga lart dhe pa zhurmë, duke lejuar vajzën në fjalë të vazhdonte mësimin pa u detyruar t'i nënshtrohet urdhrit të rektorit që përsëriste refrenin “shkolla është laike”.

Nëse në vitet e shkuara vajzat me shami ose kanë braktisur shkollën, për të mbajtur shaminë, ose kanë gjetur mirëkuptim dhe tolerancë nga drejtuesit arsimorë për t'i lejuar ato në heshtje, edhe pse rastet e fundit janë më të shumtat larg Tiranës dhe në rajone me ndjesi të lartë fetare, në këto vitet e fundit duket se zgjidhja ka qenë e imponuar më shumë nga politika e djalhtë në pushtet, sesa nga ndonjë përpjekje iniciuese nga vetë muslimanët.

Në vitin 2008 një tjetër rast, kësaj herë në një shkollë tetëvjeçare të kryeqytetit do të rindezte debatin publik, për t'u pasuar pas pak ditësh nga një rast i ngjashëm në një shkollë të mesme të Burrelit. Por duket se kësaj herë muslimanët ishin më të ndërgjegjësuar, sesa disa vite më parë, kështu që si asnjëherë më parë rreth njëzet shoqata muslimane bashkë me një organizatë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të bënin një prononcim publik, ku mbronin të drejtën e mbajtjes së shamisë dhe dënonin privimin e saj në

arsimin publik. Mirëpo edhe pas kësaj asnjë dritë jeshile në aspektin ligjor nuk dukej se do t'i jepte zgjidhje këtij problemi, përveç faktit që të shpresojë në zgjidhje individuale aty këtu dhe të hëpërhëshme nga lart.

Në fillim të 2010 organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut i paraqesin qeverisë dhe më pas parlamentit një draft ligjor për të mosdiskriminimin e njerëzve për shkak të bindjeve fetare, politike, kulturore, apo prirjeve seksuale, apo origjinës etnike... etj. Ligji para se të miratohej në parlament u njoh si ligji për "homoseksualët", pasi ai tashmë ndalonte këtë kategori njerëzish të diskriminoheshin për shkak të këtij vesi (të ndyrë), akt i cili deri pak vite më parë dënohej me ligj. Ishte disi absurde të viheshe në një pozicion të tillë, që të kërkoje miratimin e këtij ligji, sepse me të shpresohet t'i vihej një herë e mirë kapak çështjes së shamisë! Por ja që absurditete të tilla që bashkojnë me hir ose me pahir antagonizma të tilla në një demokraci liberale janë të zakonshme. Edhe pse ligji në momentin final pati ndryshime, që preknin pikërisht atë që u interesonte muslimanëve, miratimi i tij u shoqërua me një zhurmë mediatike, se ai krahas mosdiskriminimit të njerëzve pervers mbronte edhe të drejtën për mos-cenimin e mbajtjes së shamisë edhe në shkollë. Por siç thotë edhe një fjalë e urtë: Kurrë mos thuaj: Kurrë! Në fund të 2010 një projektligj për arsimin parauniversitar i hedhur për sugjerime nga Ministria e Arsimit, dhe më konkretisht një nen i tij, rindezi debatin e shamive, që dukej se pas kaq vitesh betejash nuk mund të mbyllej kaq lehtë. Reagimet nga ana e muslimanëve dhe polemikat në media u shkaktuan nga një formulim i paqartë ligjor, që bëhej në këtë ligj për çështjen e

simboleve fetare. Në njërin krah për muslimanët shamia nuk është thjesht një simbol, por një detyrim hyjnor, në krahun tjetër ajo për refuzuesit e saj përbënte një fetarizëm të dukshëm simbolik, i tillë që cenonte laicitetin e shkollës. Krahas debateve publike e mediatike pro dhe kundra shamisë në shkollat publike, muslimanët e Shqipërisë si asnjëherë më parë, në nivel individual dhe kolektiv, në rang organizatash dhe personash, lëshuan një rrebesh reagimesh, që kërkonin mbrojtjen e kësaj të drejte. Por politika edhe kësaj here hezitoi të shprehej haptazi për këtë problem, ndonëse nuk munguan interpretimet dhe pohimet publike kontradiktore. Gjithsesi premtime politikanësh në kontakte individuale nuk kanë munguar edhe kësaj here, por edhe nëse vërtetë ligji do të miratohet me ndryshimet e kërkuara, a thua vallë çështja e shamisë nëpër shkollë do të marrë fund këtu? A nuk do të ishte vallë më mirë, sesa të kërkonim të përfshihemi në ligje mosdiskriminuese dhe të përjashtohemi nga ligje ndaluese, të kërkonim diçka më pohuese, që do të sanksiononte më në fund me ligj lejimin e shamisë? Duket se muslimanët shqiptarë akoma janë peng e anekseve ligjore, që prodhojnë të tjerët dhe akoma nuk po dinë të dalin nga strukja e këtyre kthinave juridike, nga ku po kërkojnë të mbrojnë të drejtën e tyre legjitime. E ndoshta deri në atë ditë, shamia do të ngelet peng e interesave të politikës. Le të shpresojmë që jo! ■



TUNIZIA... PËRFUNDIMI I NJË SHEJTANI TRONDIT KARRIGET E TË TJERËVE

Në fund sistemi i Ibën Aliut nuk mundi ta vazhdojë mashtrimin. Në përballjen me popullin ai ra që në provimin e parë, ai doli shumë më i brishtë sesa i varrosuri Habib Burgiba që ishte

ABDULBAKI HALIFE

Këto ditë Tunizia po shkruan një histori me shkronja të arta. Bijtë e saj arritën ta thyejnë hallkën më të fortë të zinxhirit diktatorial që rrethon rajonin arab, nga veriu deri në jug dhe nga lindja deri në perëndim. Revolucion i popullor tunizian rrëzoi kryetarin më të fortë arab për sa i përket nivelit të lartë të shtypjes mbi popullin dhe aparatin më të fuqishëm të sigurimit në rajonin arab. Tunizia njihej si vendi i grushtit të hekurt dhe i sistemit që konsiderohet shembull për çrrënjosjen dhe zhdukjen e Lëvizjes Islamike, mirëpo tashti pas 23 viteve ai sistem u detyrua ta konsiderojë publikun tjetër, të cilët Ibën Aliu nuk i ka llogaritur

fare, madje i ka shikuar si një pjesë e pronës personale, saqë me ta apo pa ata kryetari mund të bëjë çfarë i ka ënda. Mirëpo mu ky publik, me një të ngritur brenda krejt udhëheqjes së këtij diktatori e detyroi të ikë si një mi i trishtuar.

Ibën Aliu tashmë iu bashkëngjit Çausheksut, Honekerit, Millosheviçit dhe të gjithë djajve të tjerë, që i njeh historia moderne. Ky shejtan u rrëzua, mirëpo e kaluara e trishtueshme ende qëndron si fantazmë e frikshme, kthimit të së cilës, por me një petk të ri i frikësohen tunizianët, duke u stimuluar nga forcat e diktaturave në pushtet, apo ushtria me ndihmë nga jashtë, sidomos nga Franca dhe fuqitë perëndimore, me qëllim që populli tunizian dhe arabët të mbeten jashtë historisë. Prandaj nga populli

tunizian kërkohet të flijojë edhe më shumë, meqë duket se *mehri* i lirisë nuk është paguar krejt, si dhe rreziku i abortit të revolucionit ende është i dukshëm, mirëpo shpresa në këmbënguljen e popullit është e gjallë akoma.

Orët e fundit

Sistemi tunizian nëpër Forumet Ndërkombëtare paraqitej sikur ishte një sistem i drejtë, luftonte terrorizmin, ishte pengesë e fortë përballë ekstremizmit dhe terrorizmit, gruas i jepte të drejtat e saj, i pasur me botëkuptime evropiane. Organizatave botërore i paraqiteshin numra të rrejshëm për nivelin e zhvillimit dhe institucionet e shoqërisë civile, si dhe përparimin që ka realizuar. Ndërsa brenda shtetit varfëria mbushte foletë, bashkë me të rritej zemërimi dhe ngulfatja nga ai sistem, zjarri i të cilit shtoej nga përkeqësimi i lirive, i të drejtave njerëzore, nga lufta kundër Islamit dhe muslimanëve nëpërmjet fushatave për përndjekjen e grave të mbuluara, burgosja dhe vrasja e bijve të Lëvizjes Islamike me ndëshkime, apo vdekje sistematike nëpërmjet helmimeve të fshehta, pengimit të ilaçeve nga ata që sëmureshin me sëmundje të rrezikshme nëpër burgje. Paralel me këto kemi edhe korrupsionin sistematik, që personifikohej në mbisundimin e familjes së Ibën Aliut dhe të dhëndurëve të tij mbi pronat e shtetit, shkelja e popullit dhe ndërtimi i pasurive të mëdha nga burime të dyshimta ligjërisht.

Në fund sistemi i Ibën Aliut nuk mundi ta vazhdojë mashtrimin. Në përballjen me popullin ai ra që në provimin e parë, ai doli shumë më i brishtë sesa i varrosuri Habib Burgiba që ishte përpara tij. Tunizia është gati të takohet me triumfin më të madh të saj në historinë e vet të pas pavarësisë, por ka drojën se mos pavarësia e dytë do t'i ngjajë pavarësisë së parë, ku Tunizia nuk arriti të ndahej plotësisht nga Franca, por mbeti në skaj të saj dhe një "bahçe pas shtëpie" e

“...Tunizia njihej si vendi i grushtit të hekurt dhe i sistemit që konsiderohet shembull për çrrënjosjen dhe zhdukjen e Lëvizjes Islamike...”

pushtimit të tërthortë francez.

Më 17 Dhjetor 2010 filloi numërimi së prapthi për sistemin e Ibën Aliut. Me daljen e çdo agimi dhe me rënien e çdo dëshmori revolucionari i afrohej realizimit të synimeve; filloi me prononcimin e diktatorit të rrëzuar Ibën Ali e deri te prononcimi i kryeministrit Muhamed el-Ganushi. Në ato prononcime të dështimit, ikjes, fshehjes nga shikimet u shfaq një përparim nga kërcënimi, inkurajimi, premtimi e frikësimi drejt arsyetimit dhe pranimit të krimeve që ata i quanin gabime! U shkua drejt përpjekjes së pranimit të përgjegjësisë për ato krime të qarqeve të caktuara, ndaj edhe u shkarkua guvernatori Sejidi Buzejd, pastaj ministri i brendshëm dhe këshilltari politik i diktatorit të rrëzuar. Pasi kjo nuk solli ndonjë përmirësim dhe publiku vazhdoi të kërkojë ikjen e shejtanit, atëherë diktatori iku pa asnjë paralajmërim. Kur avioni i tij doli nga hapësira ajrore tuniziane u lajmërua ikja e tij përgjithmonë, duke e lënë Tunizinë të zhytur në gjak dhe kaos, që e sollën dhe po e sjellin ende aparatet e tij, duke u hakmarrë nga populli dhe revolucionari që po bëjnë, duke u munduar ta shëmtojnë dhe t'i japin fund siç bënë në Algjeri dhe vende të tjera.

Shejtani u rrëzua bishtat mbetën

Ibën Aliu u rrëzua dhe askujt nuk i vjen keq për të. Mbetjet e karrieristëve dhe oportunistëve nuk arritën ta mbrojnë pavarësisht përpjekjeve teatrale nga ata për të dalë në rrugë, mirëpo i kapi rryma dhe me një shpejtësi të paparë u zhdukën.

Revolucioni ka vendosur themelet për një realitet të ri, tashmë kthim mbrapa nuk ka, si dhe nuk ka hapësirë për një diktator të ri në Tunizi në emër të ushtrisë, e cila qëndron pas ikjes së Ibën Aliut nga jeta politike e Tunizisë. Tashmë nuk duhet që ushtria të vazhdojë lëvizjen e kukullave pas perdes. Ajo duhet t'i kthehet gjithsesi rolit të vet, ndërsa pushtetin duhet t'ia dorëzojë popullit pasi të zgjedhin kryetarin dhe parlamentin e ri dhe pasi të pajtohen rrymat dhe partitë e ndryshme politike me kushtetutën e re të vendit, me të cilën do të rregullojnë lirinë dhe pushtetin e popullit.

Krahas faktit se ushtria ka në kontroll situatën ekziston frika nga bishtat e sistemit të mëparshëm, që ende vazhdojnë të ekzistojnë në shtet, madje edhe në ushtri dhe që do të tentojnë të vjelin frytet e revolucionit të popullit tunizian, i cili gjithsesi duhet të ketë sukses dhe të mbrohet mirë për t'u regjistruar në histori si revolucion i më i pastër, që ka njohur bota në kohën moderne. Shumë personalitete politike opozitare bënë apel në popull, që të vazhdojnë të rrinë në rrugë derisa të marrin përgjigje të sigurta për kërkesat e tyre.

Revolucioni tunizian dhe gjendja arabe

Në opinionin e gjerë arab nuk pritet ndonjë e mirë për Tunizinë. Popujt arabë shikojnë me habi dhe ftohtësi arritjet e popullit tunizian, i cili vetëm me gjoks pa mburojë i doli përpara plumbave të sistemit diktatorial, që ishte ndër sistemet më shtypëse në rajon, ndërsa pas revolucionit u shfaq i përlurur, i dobët, fatkeq sikur të kishte qenë një imagjinatë e frikshme në zemrat dhe mendjet e njerëzve më herët dhe jo realitet. Ajo pranoi të bëjë lëshime të shpejta për t'i dhënë të drejta qytetarit tunizian, të lirojë çmimin e produkteve themelore mirëpo kishte kaluar koha. Tashmë shumë vende arabe, si Jordania, Libia dhe Maroku kanë mësyre lirinë e çmimeve, për t'i ikur asaj

“Shumë qarqe thonë se revolucioni tunizian po shkakton lëvizje të sistemet e tjera arabe nga frika e përhapjes së “epidemisë” edhe tek ata....”

çfarë i ndodhi sistemit tunizian. Shumë qarqe thonë se revolucioni tunizian po shkakton lëvizje të sistemet e tjera arabe nga frika e përhapjes së “epidemisë” edhe tek ata.

Atyre sistemeve edhe më shumë ua shton frikën përballja me përfundimin e sistemit të rrëzuar tunizian dhe përfundimi i Ibën Aliut personalisht, i cili shihej si një nga diktatorët që ushtronin pushtet të sigurt, pa asnjë frikë nga populli. Sidomos kur dihet që Tunizia për sa i përket sistemit i ngjante shumë sistemeve që ushtrohen ende në Libi, Egjipt, Algjeri, Marok, Jordani etj. Madje këto të fundit janë edhe më të brishta sikur të viheshin para një provimi të vërtetë, siç qe ai i Tunizisë. Veçanërisht kur kemi parasysh faktin se Franca mbajti krahun e Ibën Aliut përgjatë 23 viteve, mirëpo prapë se prapë refuzoi që avioni i tij të ulet në tokën e saj, siç refuzoi Italia dhe Malta dhe mbeti me orë të tëra duke kërkuar strehim derisa e gjeti atë në Xhide.

Kjo situatë është një letër e qartë drejtuar sistemeve arabe, se askush në Perëndim nuk i qan ata (as nuk i strehon), edhe pse e ndihmojnë diktaturën e tyre, ndërsa Mbretëria e Arabisë Saudite që i dha strehim diktatorit tunizian, e kushtëzoi atë – siç u publikua – të jetë refugjat politik dhe të mos guxojë të ushtrojë ndonjë aktivitet politik në tokën e saj dhe të mos bëjë asnjë intervistë me gazetarë me qëllim që të mos irritojë popullin tunizian dhe udhëheqjen e ardhshme të Tunizisë. Ky ishte një qëndrim i urtë. Popujt mbeten ndërsa udhëheqësit ikin, qoftë me këtë apo me një mënyrë tjetër. Mjafton vdekja si këshillë. ■

Përktheu: Omer B.

DHJETË DITË QË TRONDITËN TIRANËN

Skenat tragjike u përcollën live nga të gjitha kanalet kryesore kryeqytetase. Një grup demonstruesish sulmuan godinën e Kryeministrit në Tiranë, duke krijuar shqetësim dhe panik në kryeqytet. Jeta politike dhe nivelet më të larta të Shtetit Shqiptar përjetuan ditë të vështira.

Shkruan: Roald A. HYSA

Për gati dhjetë ditë rresht Shqipëria përjetoj një nga ngjarjet më të vështira e dramatike të politikës së saj brenda këtij dhjetëvjeçarit të fundit. Ishte një demonstratë e paralajmëruar qysh më herët, por që asnjërit nga qytetarëve të thjeshtë tiranas e të mbarë Shqipërisë nuk ia mori mendja, se do të përfundonte në një luftë guerile “qytetare” kundra institucioneve shtetërore. Tashmë kur Shqipëria kishte hyrë në procese të rregullta politike të brendshme e ndërkombëtare iu desh të përballej me një demonstratë të përmasave shumë shqetësuese për të gjithë qytetarët e Tiranës. E gjitha u transmetua *live*. Të gjithë e panë atë që ndodhi atë pasdite të xhumasë së 21 janarit. Kur të gjithë ne mendonim se do të ishte një fundjave i zakonshëm dhe shumë prej nesh ishim ulur në ndonjë kafeteri pas xhumasë, pamjet e ofruara *live* të kanaleve kryesore private në Tiranë na ofruan pamje djegiesh, goditjesh me gurë dhe njerëzish të irrituar e të eksituar, që qëllonin mbi rreshtat e policëve dhe më pas

të gardistëve në përpjekje për t’u futur në godinën e Kryeministrit. Nisi shumë qetë rreth orës 14,00 për të degjeneruar në një guerilje urbane, ku të dyja palët ishin shqiptarët. Bilanci i kësaj lufte të paprecedent ishte tragjik. Katër të vrarë dhe rreth 45 të plagosur. Katër civilë të vdekur pa asnjë lloj motivi. 45 të plagosur gardistë e policë në krye të detyrës. Në një nga momentet më tragjike të asaj dite, shumë domethënëse ishte gjesti i një oficeri, të cilit kur iu vërvit flamuri shqiptar ai nuk i përfilli gurët, por u ul dhe e ngriti. Simboli kryesor i këtij shteti të ngritur me njëqind halle dhe me mbështetje të vazhdueshme nga Evropa u vërvit si një leckë e zakonshme, që mund të blihet në treg nga ndonjë tregtar flamujsh. Gjithsesi beteja e vërtetë nisi pas orës 18 të mbrëmjes, kur demonstruesit u tërhoqën në masë dhe filluan arrestimet e ndalimet e tyre. Më pas një betejë e ndezur mediatike do të fillonte nga lideri i opozitës Edi Rama, i cili qysh në momentet e para i përdori katër civilët e vrarë në demonstratë për të kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Berisha. Ndërkaq u vu në qarkullim një

video në internet, ku ishte regjistruar vrasja e njërit prej civilëve. Një betejë e ashpër mediatike u përsoll rreth kësaj videoje, ku qartas dukej një grup njerëzish, të cilët në momentin e vrasjes së civilit lëviznin në mënyrë krejt të dyshimtë. Opozita u kap pas kësaj videoje dhe vrasjes së civilëve në ditët në vijim, duke u munduar të përfitojë kapital politik dhe të hidhte poshtë kryeministrin Berisha dhe për ta kaluar vendin në zgjedhje të parakohshme. Kjo alternativë iu vu përpara kryeministrit Berisha si e vetmja e mundshme dhe pavarësisht nga ndërhyrjet e mediatorëve ndërkombëtarë që mbërritën në Tiranë, nuk u ofrua ndonjë zgjidhje tjetër për situatën. Ndërkaq shumë emblematike do të ishte deklarata e Ambasadës së SHBA në Tiranë 24 orë përpara trazirave, e cila iu kërkonte në mënyrë ekspresive qytetarëve amerikanë në Shqipëri t'i qëndronin sa më larg pjesës së bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, ku edhe u zhvilluan ngjarjet tragjike. Ndërsa tingëlloi shumë keq deklarata e kryeprokurores Ina Rama, që i cilësoi këto zhvillime tragjike “ngjarja në bulevard”, a thua se ishte një zënkë rrugaçësh. Beteja midis dy palëve do të vazhdonte në ditët në vijim, jo vetëm për zhvillimin e hetimeve për zbardhjen e vrasjeve, porse tashmë ishin paralajmëruar dy mitingje, njëri nga pozita, fillimisht për të mërkurën 26 janar, por që u shty më pas për të shtunën dhe tjetri nga opozita për të premten në vijim. Presioni ndërkombëtar dhe një lëvizje e papritur e kryeministrit Berisha bënë që ai të tërhiqet nga ky miting paqësor, siç u shpreh ai dhe ta kalonte topin në fushën e kundërshtarit. E gjithë gazetaria tiranase dhe opinionistët nuk lanë skenar pa implikuar në shqyrtimet e tyre, saqë njerëzit e thjeshtë u mpinë nga këto lajme të vazhdueshme dhe analiza. Dita e premte erdhi dhe shqiptarëve nëpërmjet të njëjtave

“Për dy të premte rresht dyqanet u mbyllën në Tiranë për të mos pësuar dëme, ndërsa imazhi i Shqipërisë evropiane është ai që u dëmtua më tepër nga skenat me zjarr, ujë, gurë e gaz lotsjellës...”

media iu ofrua një tjetër pamje. Ajo e një funerali të stërmadh, ku përfshihehin elementet e një idhujtarie moderne. Në krye të tyre u shfaq kryebashkiaku i Tiranës me shiritat kuq e zi dhe një turmë krejtësisht paqësore dhe krejtësisht ndryshe nga një javë më parë. Gati një demonstratë më vete ishin ata që kishin marrë përsipër drejtimin e demonstratës funebre të kësaj radhe. Një ndryshim radikal, i cili fliste jo më nëpërmjet fjalëve dhe retorikave boshe të politikës, por nëpërmjet portreteve gjigante të të vrarëve dhe liderëve socialistë të veshur në zi, që hidhnin lule dhe ndiznin qirin për viktimat, duke përkëdhelur portretet e tyre. Kortezi socialist kaloi në revistë paqësore portretet masive, madje u derdhën edhe shumë lot dhimbje për të vrarët. Tashmë e gjithë kjo betejë hë për hë u mbyll me një deklaratë të kryetarit Rama, i cili tha se ne nuk do të reshtim ta ngremë sa më lart “Zërin e Popullit”. Kështu ai u tërhoq për momentin, por pa reshtur akoma betejën e tij politike për të marrë karrigen e kryeministrit Berisha. Për dy të premte rresht dyqanet u mbyllën në Tiranë për të mos pësuar dëme, ndërsa imazhi i Shqipërisë evropiane është ai që u dëmtua më tepër nga skenat me zjarr, ujë, gurë e gaz lotsjellës. Këto pamje janë kthyer në një regres politik ndërkombëtar me kosto të lartë për shqiptarët. ■

PEZULLOHET NDALESA PËR FEREXHENË MUSLIMANE NË KATALONJË

Gjykata e Lartë e Katalonjës në Spanjë ka pezulluar ndalimin e ferexhesë në vendet publike për gratë muslimane në qytetin Lleida. Sipas këtij vendimi të miratuar më 12 Janar 2011 thuhet se ndalimi i ferexhesë muslimane do të hiqet deri në ndonjë vendim tjetër pas shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga shoqata muslimane Watan. Autoritetet e qytetit katalanas Lleida ishin ndër të parët, që vendosën për ndalesën e ferexhesë muslimane në Evropë. ■

SIMBOLET FETARE, TËRHIQET MASH: PROJEKTLIGJI MUND TË NDRYSHOHET

Projektligji për arsimin e detyruar dhe të mesëm në Shqipëri, nuk do të bjerë ndesh me Kushtetutën dhe ligjin e mosdiskriminimit. Kështu është shprehur sot Ministri i Arsimit Myqerem Tafaj. Fjala është për pikën 4 të nenit 36 të projektligjit që interpretohet nga komunitetet fetare si masë ndaluese, veçanërisht për mbajtjen e shamisë nga vajzat muslimane gjatë frekuentimit të shkollës. Ministri Tafaj shprehet se “projektligji është në diskutim publik dhe nuk është përfundimtar. Ligji do të jetë në përputhje me Kushtetutën me Konventat Ndërkombëtare, me ligjin e mosdiskriminimit dhe ligje të tjera, që prekin aspekte të sistemit të edukimit”, u shpreh Tafaj. ■

BIE MBËSHTETJA AMERIKANE PËR LUFTËN NË AFGANISTAN

Hulumtimi i zhvilluar nga universiteti Kuinipak tregon se shumica e votuesve besonin se SHBA-të nuk duhet të përfshihen në luftën në Afganistan. Niveli i mbështetjes në anketë ka rënë në 41%, që është edhe më poshtë se kulmi prej 59% para një viti. Ndërkohë Australia dhe Britania kanë paralajmëruar se 2011 dhe 2012 do të jenë vitet vendimtare për luftën në Afganistan, gjersa forca udhëheqëse në këtë luftë do të kenë kohë të vështira përpara. Pothuajse një dekadë që nga pushtimi i Afganistanit prej forcave të drejtuara nga SHBA-të, forcat e huaja po përjetojnë kohë të vështira me viktima në rritje. ■

BFIM: OSE PRISHNI KISHËN, OSE NDËRTONI XHAMINË

Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë (BFIM) kërkon që sa më shpejt të prishet objekti - kishë që po ndërtohet në kala, në të kundërt do të duhet që patjetër të ndërtohet edhe xhamia e Hakik Pashës që gjendet po në Kalanë e Shkupit. “Jemi të sigurt se ai objekt do të përdoret për kishë dhe për rituale fetare, prandaj kërkojmë mbrojtjen e kulturës islame dhe barazi fetare”, tha Jakup Selimovski, përgjegjës i sektorit për arsim dhe kulturë pranë BFIM-së. Ai thotë se Kalaja është një vend i mbrojtur me ligj në të cilin gërshtohen civilizimet e ndryshme, ku civilizimi i fundit është ai islam. “Në kala mund të kryhen kërkime arkeologjike dhe

të konservohen gjetjet arkeologjike, por kurrësi nuk duhet që aty të ndërtohet. Ai është një objekt i paligjshëm që duhet prishur menjëherë, sepse ndërtimi i tij dëshiron të varrosë kulturën islame”, thotë ai, duke përmendur emrat e xhamive të cilat nuk lejohet të rindërtohen. “Kemi Jeni xhaminë në Manastir të cilën e shndërruan në muze, kemi xhaminë e Prilepit që nuk lejohet të ndërtohet, kemi Burmalinë në Shkup, gjithashtu në kala kemi xhaminë e Hakik Pashës...”, thotë Selimovski. Gjatë takimit që Selimovski ka pasur me drejtorin e Drejtorisë për Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore (DMTK), Pasko Kuzman, ai i ka thënë drejtorit Kuzman se në të njëjtën mënyrë le ta ndërtojnë dhe xhaminë dhe tyrben. Reagimi i Kuzmanit ka qenë i ashpër, e ka lidhur BFIM-në me vehabistët, gjë që nuk ka lidhje me realitetin. /gazeta lajm/ ■

TAKOHET REDAKSIA E REVISTËS ALBISLAM

Anëtarët dhe bashkëpunëtorët e redaksisë së revistës Albislam, më 16 Janar 2011 u takuan në Prishtinë për të shtjelluar ecurinë e deritashme të revistës dhe për të krijuar vizionin e të ardhmes. Arritja e botimit të revistës deri në numrin 90, me material ekskluziv dhe vetë-financimi janë shenja të suksesit – raportoi Omer Berisha.

Por që të rritet ai sukses nga çdo anë – u pajtuan të gjithë – në të ardhmen duhet përqendruar edhe më shumë në shtjellimin e situatave që kanë të bëjnë besimtarët e këtij nënqielli, duke i lënë hapësirë për të kontribuar me shkrime, analiza dhe hulumtime çdo dashamiri. “Çdo kontribut që pajtohet me parimet dhe vizionin e revistës duhet të jetë i mirëseardhur nga

kushdo qoftë” do të shprehet Ekrem Avdiu duke përkrahur kështu diskutimin e Driton Lekaj. Ali Shabani foli për sfidat e kaluara me sukses gjatë vitit 2010 dhe shprehu bindjen se gjithçka do të bëhet edhe më mirë nëse përqendrohemi sinqerisht në punën e mëtejme. Gjithashtu u përkrah fuqishëm propozimi i redaktorit gjuhësor Roald Hysa që nëse brenda këtij kuadri përfshiheshin gratë do të ishte akoma edhe më mirë, si p.sh. të merreshin me përgatitjen e shkrimeve, apo të ishin edhe temë e shkrimit. ■

KAMATAT E LARTA FALIMENTOJNË BIZNESET

Në Kosovë vetëm gjatë vitit 2010 janë shuar afër 1400 biznese, thonë zyrtarë të qeverisë në dorëheqje. Sipas tyre, kamatat e larta të kredive mbeten shkak kryesor i falimentimit të bizneseve. Arsytet, sipas tyre, janë të ndryshme, por në shumë raste, falimentimi ka ndodhur si pasojë e pamundësisë së kthimit të kredisë, për shkak të kamatave të larta të interesit. Në anën tjetër, ekspertë për çështjet ekonomike, nuk pajtohen me arsyen e shuarjes së kompanive, raporton Radio Evropa e Lirë. ■

IZRAEL, ARRESTOHET I DYSHUARI PËR MASAKRËN E SREBRENICËS

Autoritetet e Izraelit thonë se kanë arrestuar ish-ushtarin serb të Bosnjës, Aleksander Cvetković, i dyshuar se ka luajtur rol në masakrën e vitit 1995, kundër

muslimanëve të Bosnjës në Srebrenicë. Ministria e Drejtësisë tha se policia e arrestoi sot të dyshuarin Cvetković, pasi qeveria e Bosnjës kishte paraqitur një kërkesë për ekstradim. Ai kërkohet si i dyshuar se ishte pjesëtar i ekipit të përzier në ekzekutimin e 8 mijë muslimanëve nga ushtarët serbë të Bosnjës, në Srebrenicë, në korrik të vitit 1995. Aleksander Cvetković kishte shkuar në Izrael me familjen e tij, në vitin 2006 dhe kishte marrë shtetësi izraelite, pasi gruaja e tij është hebreje. ■

MAQEDONIA DO MIRATOJË LIGJIN KUNDËR MARTESËS SË HOMOSEKSUALËVE

Partia qeverisëse në Maqedoni VMRO-DPMNE po përgatit amendamentet kushtetuese, të cilat do të ndalojnë në mënyrë eksplicite martesat ndërmjet homoseksualëve. Mediet maqedonase raportojnë, se VMRO-DPMNE pret mbështetjen e partnerëve të koalicionit për ligjin, që do të votohet në afatin prej tre muajsh. Çiftet e gjinisë së njëjtë ka kohë që janë temë diskutimi në Maqedoni. ■

KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË DEKLAROHET KUNDËR DHUNËS

Komuniteti Musliman i Shqipërisë reagoi duke shprehur keqardhjen për dhunën dhe duke bërë thirrje për vetëpërmbytje ndaj ngjarjeve të 21 janarit. “Të gjithë kemi qenë dëshmitarë të një situatë aspak të denjë dhe të merituar për vendin tonë. Komuniteti

Musliman i Shqipërisë shpreh keqardhjen e tij për jetët e humbura, si dhe për dhunën dhe kaosin e shfaqur (21 janar 2011) në orët e pasdites në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”. I bëjmë thirrje të gjithë popullit për vetëpërmbytje dhe të mos bien pre e asnjë provokimi dashakeqës dhe urrejtjendjellës, që mund të bëhet shkak për përsëritjen e skenave të tilla, pasi si forcat e policisë edhe protestuesit janë vëllezërit tanë dhe bijtë e këtij vendi”, – deklaroi KMSH. Komuniteti Musliman deklaroi se të gjithë duhet të jenë në dijeni se nuk ka fitimtarë, ndërkohë që nxiti palët për dialog, në respekt të qetësisë publike dhe në të mirë të vendit dhe të shoqërisë. ■

MAGJISTRON LLOKMAN HOXHA

Llokman Hoxha, redaktori i rubrikës “ekonomi” në revistën Albislam mbrojti me sukses temën e magistraturës në Universitetin e Sharikas, fakulteti i Sheriatit më 30 Janar 2011. Llokman Hoxha u lind më 10 Shkurt 1980 në Shkup, kreu medresenë “Alaudin” në Prishtinë, pastaj fakultetin e Sheriatit në Universitetin Islamik në Medinë. Studimi tij me titullin: **“Praktikat e autorizimit në transaksionet bankare islame”** që arriti 425 faqe shtjellon çështjet financiare bashkëkohore që kanë të bëjnë me autorizimin, studion mendimet e dijetarëve për të arritur mendimin përfundim në të mirë.

Redaksia e revistës Albislam i uron hoxhës Llokman Hoxha për suksesin e arritur dhe e lutë Allahun që sukseset e tij të vazhdojnë më tej duke e bërë të dobishëm për vendin tonë fillimisht e pastaj edhe për gjithë Umetin... ■

BETEJA E PAPËRFUNDUAR KUNDËR HIXHABIT

SHKRUAN: TALHA KURTISHI

Duke vendosur t'i bindet Allahut dhe ligjit të tij, besimtari e ka reduktuar dukshëm numrin e dilemave dhe udhëkryqeve në jetën e tij. Me besimin se Allahu, *subhanehu ue teala*, në mënyrë absolute dhe pa mangësi e ka zgjedhur më të drejtën dhe më të dobishmen për njeriun dhe njerëzimin, ai parimisht është përcaktuar për zbatimin e ligjit hyjnor në

jetën e tij. Kështu i është lehtësuar puna e zgjedhjes dhe i është shkurtuar rruga deri tek e dobishmja në dynja dhe në ahiret. Ky përcaktim edhe pse në esencë është vepër abstrakte, që i përket zemrës nuk ndalet tek aspekti i brendshëm i besimit. Përkundrazi ai reflektohet edhe në aktet e adhurimit që i kryejnë gjuha dhe gjymtyrët. Kështu njeriu, si tërësi e pandashme e shpreh nënshtrimin e tij ndaj Allahut me bindjen e zemrës, me fjalët e




gjuhës dhe me adhurimet e gjymtyrëve. Edhe hixhabi i motrave muslimane është një pjesë e rëndësishme e adhurimeve të dukshme më të cilët madhërohet Allahu. Allahu, *subhanehu ue teala*, e ka urdhëruar qartë hixhabin si veshje me të cilën duhet të dallohet dhe të stoliset femra muslimane. Ai ngërthen në vetvete kuptime të shumanshme siç janë: shprehja e bindjes ndaj Allahut, falënderimit, nënshtrimit, strehimit tek Allahu, simboli i ndershmërisë dhe parandalues i ngacmimeve dhe lajthitjeve të shfrenuara. Hixhabin si pjesë e praktikës islame e ka përshtetur shumë bukur mendimtari musliman Meududi, i cili në librin e tij **Hixhabi** shkruan: Kjo përmbledhje e dispozitave të cilën ne muslimanët e quajmë hixhab realisht i ka përmbledhur në vetvete pjesët më të rëndësishme të sistemit shoqëror Islam. Ky sistem është i pranueshëm për çdonjërin që ka trashëguar dituri të dobishme dhe ka natyrë të paprishur. Hixhabi është pjesë e pandashme e sistemit shoqëror Islam dhe si i tillë është njëri prej boshteve të sistemit, që garanton mesatarinë dhe drejtësinë. Me këtë natyrë fisnike hixhabi ka qenë dhe është cak i shumë fushatave për zhdukjen e tij. Sulmet e ashpra kundër hixhabit dhe angazhimi për ndalimin e tij nuk janë prodhim ekskluziv i kohës sonë. Ata fillimisht janë paraqitur pas rënies së kalifatit Islam nën udhëheqjen e pushtuesve dhe kolonizatorëve. Duke u orvatur që popujt e pushtuar t'i detyrojnë të pranojnë kulturën e tyre ata janë angazhuar t'i ndërprejnë të gjitha lidhjet mes popujve të nënshtruar dhe kulturës së tyre. Në krye të listës së dukurive që duhej të luftoheshin, për të siguruar nënshtrimin ideologjik të popujve muslimanë ishte Islami dhe veçoritë e jetës Islame, që u garantonin një jetë fisnike

popujve. Hixhabi ishte njëra prej dukurive islame, që u luftua në mënyrën më të ashpër. Në shumë vende muslimane si shenjë e të ashtuquajturit çlirim të gruas u proklamua zhveshja e saj nga hixhabi. Më e dhimbshme ishte lufta që zhvillohej kundër hixhabit nga armiqtë e nderit, që iu përkisnin popujve muslimanë, që flisnin gjuhën e tyre dhe identifikoheshin ndoshta edhe si muslimanë të përkushtuar. Për një kohë të shkurtër, si pasojë e luftës së pamëshirshme ideologjike hixhabi si dukuri u humb në shumë shoqëri në të cilat më parë mbahej me krenari. Përgjashtim ishin disa vende, të cilët i rezistuan fushatës së egër kundër hixhabit. Ajo që të shqetëson më shumë ishte gënjeshtria, se gjoja hixhabi e pengon emancipimin e gruas, arsimimin e saj dhe frenon çlirimin e saj nga hegjemonia e gjinisë mashkullore. Një shabllon propagandistik ishte gruaja e arsimuar, e çliruar, e emancipuar dhe ishte gjithnjë pa shami?!... U vendosën edhe ligje të shkruara dhe të pashkruara prej të cilëve nënkuptohej se gruaja me hixhab nuk është e mirëseardhur. Por a thua vallë gruaja që hoqi dorë nga hixhabi i saj arriti të çlirohet me të vërtetë? Statistikat flasin se gruaja vazhdon të jetë e diskriminuar edhe në botën e industrializuar. Pagat e tyre janë më të ulëta (ato kryejnë 66% prej punëve në botë, ndërsa marrin vetëm 11% prej pagave krahasuar me meshkujt). Hasin vështirësi kur punësohen, edhe kur punësohen shpeshherë bien viktima të ngacmimeve seksuale, nënat shtatzëne në shumë vende bëjnë teste për ta zbuluar gjininë e fetusit, që pastaj të bëjnë abort, nëse fetusi është i gjinisë femërore, dukshëm rritet edhe përqindja e vajzave që ngelin shtatzënë në moshën minore, në SHBA regjistrohen 4,2 miliona krime të natyrës seksuale (këtu nuk numërohen

krimet seksuale që kryhen ndaj vajzave nën moshën 12 vjeçare) dhe ato janë vetëm 16% prej rasteve që raportohen tek organet e hetuesisë (mbi 70% të rasteve të përdhunimit nuk raportohen). Faktet flasin se pozita e gruas së “çliruar” prej hixhabit nuk është edhe aq shpresëdhënëse. Përkundër fushatave të ashpra kundër hixhabit, me kalimin e kohës dukuria e mbulesës Islame filloi të rishfaqet në jetën e njeriut bashkëkohor. Shkaku ishte fakti se shumë ideologji të ndryshme nuk arritën t’ia gjejnë gruas vendin e duhur, nuk arritën ta mbrojnë dhe ta nderojnë, ta kuptojnë dhe ta drejtojnë ashtu siç e bëri atë Islami. Ato kishin kuptuar se roli i tyre në botëkuptimet e ndryshme është shumë i ulët dhe në shumë raste lidhet vetëm me trupin/gjininë e tyre. Tundimet e shumta ideologjike, keqpërdorimi i natyrës së saj, mungesa e qetësisë shpirtërore ishin shkaqet pse shumë vajza përsëri e gjetën prehjen e tyre pranë Allahut, duke zbatuar urdhrat e Allahut në mes të cilëve është edhe hixhabi. Kjo dukuri filloi t’i shqetësojë armiqtë dhe filluan përsëri thirrjet për ndalimin e hixhabit. Fushata që filloi në Francë me jehonat e saj në shume vende evropiane u afrua edhe pranë trojeve tona arbërore. Pas Kosovës edhe në Shqipëri filloi debati për ndalimin e shamisë në shkollat publike. Menjëherë u harruan parimet në të cilat përbetohet demokracia, siç janë liria e shprehjes dhe e praktikimit të bindjeve dhe besimit, liria individuale e zgjedhjes, e drejta e çdokujt të arsimohet, të marrë pjesë në drejtimin dhe të përfitojë shërbimet që i ofrojnë institucionet e shtetit, ku bëjnë pjesë edhe shkollat publike. Në kohën kur dikush angazhohet zellshëm që t’i mbrojë “të drejtat dhe liritë” më të shfrenuara seksuale, madje edhe kërkon një kornizë

ligjore për këtë mbrojtje, nuk ka irritim më të madh për muslimanët se sa ngritja e çështjes së mbulesës në shkollat publike. Këto akte vetëm se dëshmojnë për demagogjinë dhe kulturën e ulët politike që kanë pushtetarët tanë kur vjen në pyetje Islami (armiku tanimë i shpallur i “botës së qytetëruar”). Ata janë të gatshëm që përnjëherë të mohojnë të gjitha parimet e të ashtuquajturës demokraci, duke bërë kufër në atë që për vete e kanë zgjedhur si fe. Nuk duhet të luani me ndjenjat e muslimanëve, ngase hixhabi si simbol dhe detyrim fetar nuk është në kundërshtim me asnjë nga parimet e lirisë dhe demokracisë që ju po promovoni. Me të nuk pengohet emancipimi i gruas, nuk cenohet toleranca fetare, nuk imponohen bindjet fetare, hixhabi nuk është si thoni vetëm traditë e jo edhe detyrim fetar, hixhabi nuk është siç thoni ju simboli i shtypjes dhe i keqpërdorimit të gruas (unë i konsideroj të tillë veshjet që promovon industria e modës), nuk pengon bashkëjetesën (dhe po, e pengon asimilimin), dhe assesi nuk pengohet arsimimi dhe ndërtimi intelektual i gruas. Prandaj nuk keni të drejtë t’ua ndaloni muslimaneve mbulesën, dhe edhe nëse ua ndaloni dijeni se historia do t’ju mbajë mend si njerëz dështakë dhe torollakë, që menduan se do të jenë të suksesshëm në betejën e dështuar kundër hixhabit.

... pa dyshim, pala e Allahut do të jetë fituese. (Maide, 56). ■



ROBËRIT E PASIONEVE

Meqë njeriu nuk ndahet nga pasionet sa të jetë gjallë dhe epshi e shoqëron gjithnjë, urdhri që t'i braktisë të gjitha ato është një absurditet. Ajo që është e mundur dhe me të cilën ngarkohet është të largojë pasionin e tij nga domeni i shkatërrimit

ABDULAZIZ ALU ABDULATIF

Të lidhesh me Allahun e Madhëruar, ta synosh Atë, ta duash afrimin me Të është themeli i Teuhidit dhe kuptimi i dëshmisë, se “Nuk ka zot që meriton të adhurohet me meritë përveç Allahut”. Allahu i Madhëruar është i Vetmi që meriton të synohet, të lutet e të kërkohet.

Muhamed ibën Abdulvehabi, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Allahu është synimi në të cilin mbështetemi. Kjo gjë duket e lehtë për ata që nuk e dinë, mirëpo shumë e madhe për ata që e dinë.”

Për atë që Allahu nuk është synimi dhe caku i Tij, patjetër duhet të ketë një synim apo qëllim tjetër robëruar për të. Këtë e ka sqaruar mirë Ibën Tejmije me fjalët e tij: “Përfundimet induktive tregojnë se njeriu sa më shumë që bëhet kryeneç ndaj

adhurimit të Allahut, aq më shumë shfaqet idhujtaria tek ai, ngase sa më shumë që ai bëhet kryeneç ndaj adhurimit të Allahut aq më shumë i shtohet varfëria dhe nevoja tek qëllimi i dëshiruar, i cili është synimi i tij.”

Ai që e vrojton me vëmendje realitetin e gjendjes tonë sheh mënyra të larmishme të varësisë së njerëzve ndaj pasioneve dhe sprovimit me ta. Të shumtë janë ata muslimanë, që kanë përthithur dashurinë e pasioneve të ndryshme, qofshin ato pasione ndaj femrave, pasurisë, rrobave, automjeteve, posteve, udhëheqësve, lojërave e klubeve të natës! Ky shkrim flet për një sërë pasionesh, të cilat kanë robëruar zemrat dhe mendjet e shumë njerëzve.

Do të ishte e udhës që në fillim të flasim në përgjithësi për qëndrimin e shëndoshë kundrejt pasioneve para së të flasim për



disa prej tyre në mënyrë të veçantë. Qëndrimi i drejtë kundrejt pasioneve është mesatar, mes qëndrimit të të degjeneruarve, mëkatarëve dhe atij murgëror, ekstrem. Të degjeneruarit humbën namazin dhe pasuan epshet, kurse murgjit ndaluan gjërat që Allahu i kishte lejuar. Feja e Allahut kujdeset për nevojat e njerëzve dhe i percepton drejt instinktet dhe pasionet, prandaj i lejon dhe i pranon ato, mirëpo pasi t'i ketë kanalizuar dhe modifikuar.

Duke vërtetuar këtë mesatari Ibën Kajimi thotë: “Meqë njeriu nuk ndahet nga pasionet sa të jetë gjallë dhe epshi e shoqëron gjithnjë, urdhri që t'i braktisë të gjitha ato është një absurditet. Ajo që është e mundur dhe me të cilën ngarkohet është të largojë pasionin e tij nga domeni i shkatërrimit dhe ta vendosë në vendin e sigurisë dhe të shpëtimit. Shembulli i kësaj është se Allahu i Madhëruar nuk e urdhëroi njeriun që të mos i dëshirojë absolutisht femrat, porse e urdhëroi që këtë dëshirë ta orientojë tek martesë e ligjshme me gra që atij i pëlqejnë prej një deri në katër dhe robëresha sa të dojë. Me këtë rrjedhë e pasionit ndryshohet prej një vendi në një tjetër, sikurse era që shndërrohet në freskim pasi mund të shkatërronte...”

“Imam Shafiu ka thënë: “Kush ndjek pasionet detyrimisht do ta kaplojë robëria e njerëzve të dynjasë.” ...”

Ndjekja e pasioneve dhe preokupimi me to shpien deri te dominimi dhe zemra bëhet rob i atyre pasioneve, siç e sqaron Ibën Tejmije: “Ata që ndjekin epshet e tyre, qofshin ato pamje, ushqime, pije apo veshje, zemrat e tyre do të mbizotërohen dhe do të bëhen robër të atyre dëshirave, që do ta shpijnë atje ku dëshirojnë ato kërkesa. Pamjet tërheqëse që njeriu i parafytyron në mendjen e tij e përpijnë zemrën e tij, si dhe e nënshtrojnë ashtu që nuk do të mund t’u kundërvihet dot, por do të mbetet e zhytur në to... zemra fundoset në gjërat që e mbizotërojnë, qofshin ato gjëra që i do apo prej të cilave frikësohet, siç ndodh me dashurinë ndaj pasurisë, famës dhe pamjeve, si dhe ai që frikësohet prej dikujt zemra dhe mendja e tij fundosen në atë frikë ashtu siç fundoset njeriu në ujë...”

Imam Shafiu ka thënë: “Kush ndjek pasionet detyrimisht do ta kaplojë robëria e njerëzve të dynjasë.”

Teprimi dhe preokupimi me pasionet është vepër e urryer, edhe me shariat, edhe me logjikë. Allahu i Madhëruar thotë: *“E pas tyre (të mirëve) erdhën pasardhës të këqij, që e lanë namazin e u dhanë pas kënaqësive (trupore), e më vonë do të hidhen në çdo të keqe (ose në Gaja).”*

I mençuri dhe largpamësi i shikon pasojat e gjërave dhe ai nuk i jep përparësi botës kalimtare ndaj asaj të pafundme. Ibën Xheuzi thotë: “Dije se në përgjithësi epshi thërret në kënaqësinë momentale pa u menduar rreth pasojave. Nxit për t’i arritur kënaqësitë në mënyrë të shpejtë, edhe pse më vonë ato do të jenë shkak për dhimbje e vuajtje, dhe humbje të kënaqësive të tjera. I mençuri e ndal veten nga një kënaqësi që pasohet me dhimbje, një pasion që trashëgon keqardhje. Vetëm kjo është e mjaftueshme për të lavdëruar mendjen dhe për të qortuar pasionin. I mençuri kur e kupton se epshi dominon detyrohet që çdo lëndë ta çojë te gjykatësi i quajtur logjikë. Ajo do ta udhëzojë që t’i marrë parasysht dobiet në të ardhmen, e nëse ka ndonjë mëdyshje e urdhëron që ta përdorë më të sigurtën për t’u mbrojtur nga epshi deri sa të bindet se sigurohet nga sherri i pasojave të këqija.”

Le ta dijë njeriu se më lehtë është të durojë në braktisjen e mashtrimit dhe sprovës së pasioneve, se të durojë pasojat e epshit, dhimbjet dhe keqardhjet e tij. Këtë e thekson Ibën Kajimi me fjalët: “Durimi në braktisjen e një pasioni është më i lehtë, se durimi i asaj që shkakton i njëjti, ngase pasioni ose do të shkaktojë dhimbje dhe dënim, ose do të humbasë një kënaqësi më të mirë, ose do të të humbë një kohë që do të shkaktojë keqardhje, ose do të cenojë nderin ekzistimi i të cilit është më i dobishëm se ai (pasioni), ose do të harxhojë pasuri mbetja e së cilës është më e mirë se harxhimi, ose do të rrëzojë famën dhe

“Le ta dijë njeriu se më lehtë është të durojë në braktisjen e mashtrimit dhe sprovës së pasioneve, se të durojë pasojat e epshit, dhimbjet dhe keqardhjet e tij...”

pozitën mbetja e të cilave është më e mirë se rrëzimi, ose do të mënjanojë një begati mbetja e së cilës është më e lezetshme dhe më e ëmbël se shfryrja e epshit, ose do t’i hapë rrugën një të poshtri që e ka pasur të mbyllur më parë, ose do të sjellë brenga, pikëllim, frikë që janë shumë më të mëdha se sa kënaqësia e epshit, ose do të shkaktojë harresën e një diturie kujtesa e së cilës është më e lezetshme se sa shfryrja e epshit, ose do t’i gëzojë armiqtë e t’i pikëllojë miqtë, ose do të pengojë arritjen e një dhuntie të ardhshme, ose do të shkaktojë një turp që do mbetet cilësi e pandarë, ngase veprat përcaktojnë karakteristikat dhe moralin.”

Është mirë të përmendet këtu rasti i një beduini, i cili dashuronte një femër. Kaloi një kohë të gjatë në këtë gjendje. Kur u takuan, e shtiu në dorë dhe u ul mbi të katrat e saj, përkujtoi Ahiretin duke thënë: Për Zotin, njeriu që shet xhenetin gjerësia e të cilit është sa qiejt dhe toka për një vend mes këmbëve të tua sa mes gishtit të madh dhe atij tregues kur bashkohen majat e tyre, vërtet është i paditur për dallimin e sipërfaqeve.” ■

Përktheu: Agim BEKIRI



FETVAJA DHE LIRIA

si pasojë e kësaj dëgjojmë këto kohët e fundit për llojet e lirisë, ndonjëherë dëgjojmë për lirinë e fetvasë, që do të thotë liria për të folur për Allahun (pa qenë kompetent për një gjë të tillë), apo më e keqja e të keqes të dalim përpara fjalës së Profetit tonë, sal-lallahu alejhi ue selem

MUHAMED ES SEIDI

Liria në kuptimin e sotshëm terminologjik e ka bazën e saj në masonizëm, lindja e saj është e huaj në prejardhje, ndërsa tek ne muslimanët ka hyrë si diçka e imponuar mbi ne, qoftë në akide, qoftë në shoqëri apo në politikë, edhe pse përdoret, i njihet kuptimi i saj gjuhësor, mirëpo kuptimi më i thellë i saj deformohet karshi nesh duke mos pasur mundësi të bëhet kurrfarë kompromisi mes saj dhe Islamit.

Ky term tek ne është shërbyer si vaji i nxehtë, i cili e zien çdo gjë që hyn në të, edhe përsikaj kësaj ne çdoherë shpejtojmë që të zhytemi në të, duke sakrifikuar më të mirën tonë, të cilën ne e posetojmë, duke mos shikuar dëmin që sjell dhe e shërben ajo.

Kështu që thuajse shumë shpesh përsërisim diçka duke mos e ditur se çfarë po themi si: Liria në akide, liria në mendim, liria në ide, liria në shprehje, liria e gruas, liria në ekonomi e kështu me radhë.

Prandaj disa mendimtarë të këtij shekulli e shfrytëzojnë këtë term në thirrjen islame, duke pretenduar Islami është fe e lirisë, ose se Islami ka ardhur me vetë lirinë, mirëpo kjo thirrje nuk mundet që të qarkullojë aspak, të jetë nga metodat e thirrjes në Islam, sepse pretenduesi i kësaj thirrje e kupton se ky term në asnjë mënyrë nuk mund të përputhet kurrë me Islamin.

Një gjë e tillë nuk mund të përputhet aspak me Islamin, edhe në qoftë se mundohemi që një gjëje si kjo t'i vendosim kushte dhe kufizime, prapë se prapë nuk mund ta quajmë liria islame, sepse këto

kushte do të ishin aq të rënda, saqë asnjëherë nuk mund të hyjnë në praktikë, kështu që do ta mashtronim veten duke pretenduar se liria absolute në çdo gjë mund të përputhet me Islamin.

Dezinformimi ka arritur në atë shkallë, saqë pretendimi se termi i lirisë në fetva, i cili përdoret në esencën e ixhtihadit (përpjekje për të arritur deri tek ndonjë dispozitë), kur tregohet për diçka që tregon për kuptimin që ka dashur të thotë Allahu për të nga dispozitat e robërve që kanë të bëjnë me punët që janë të detyruar t'i bëjnë ata, është përzier me lirinë e mendimit pa kufi. Kështu që si pasojë e kësaj dëgjojmë këto kohët e fundit për llojet e lirisë, ndonjëherë dëgjojmë për lirinë e fetvasë, që do të thotë liria për të folur për Allahun (pa qenë kompetent për një gjë të tillë), apo më e keqja e të keqes të dalim përpara fjalës së Profetit tonë, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Këto gjëra i kam dëgjuar nga disa shkruar të shtypit, po ashtu edhe në gazetetat arabe, mirëpo deri këtu jam ruajtur e i kam mbyllur buzët për këta njerëz. I jam lutur Allahut t'i udhëzojë, mirëpo kur pashë se një term i tillë po përdoret edhe në librat akademike, atëherë prej kësaj m'u paraqit ideja që t'i paralajmëroj muslimanët të kenë kujdes nga ky term, i cili është futur në mendimet tona bashkëkohore në një shkallë të atillë, saqë që duhet të kemi kujdes patjetër ndaj tij, pra, ka arritur në një shkallë të padëshirueshme për ne.

Termi liri në kohët e para islame nuk është njohur përveç se karshi termit robëri, ndërsa nuk është përdorur asnjëherë në atë

“Termi liri në kohët e para islame nuk është njohur përveç se karshi termit robëri, ndërsa nuk është përdorur asnjëherë në atë kuptim që përdoret sot...”

kuptim që përdoret sot, bile një kuptim i lirisë siç shprehet sot nuk mund të përputhet fare me fenë tonë islame, e cila ka rregullat e veta për të na mësuar se si të jetojmë, që kur zgjohemi e deri kur biem në gjumë kemi dispozita, se si e trajton Islami çështjen e gjumit, ku edhe kjo gjendje ka lidhje prapëseprapë me fenë tonë.

Njeriu është rob i Allahut dashje pa dashje, ndërsa muslimani është rob i Allahut me dëshirën e tij. Ky është një vendim të cilin duhet ta zbatojmë dhe të ecim sipas hapave të tij, prandaj muslimani është rob i Allahut në besimin e tij, në mendimet e tij, në idetë e tij, burrë qoftë ai apo grua, në asnjë mënyrë burri nuk mund t'i ikë robërisë së tij karshi Allahut Fuqiplotë dhe e njëjta gjë vlen edhe për gruan.

Për këtë fetvaja është diçka karakteristike në qenien e saj, ngase ajo është një lloj adhurimi si namazi, zekati, agjërimi, apo haxhi. Është farz ajn (detyrë për çdonjërin) për atë që e merr një përgjegjësi të tillë, po ashtu edhe i plotëson kushtet e saj, ndërsa farzi kifaje është për dikë që është kompetent për të, ndërsa haram për dikë, i cili nuk është kompetent për të.

Ibadetet duhet t'i plotësojnë patjetër kushtet e tyre, sepse ato lidhen ngushtë me pranimin e tyre, gjithashtu edhe shtyllat janë kusht për pranimin e tyre, ndërsa vaxhibet janë pjesë përbërëse të tyre, prandaj kush i bën adhurimet pa u kujdesur t'i çojë në vend kushtet, shtyllat, vaxhibet,

“Njeriu është rob i Allahut dashje pa dashje, ndërsa muslimani është rob i Allahut me dëshirën e tij...”

ky njeri ka rënë në haram dhe ka bërë mëkat, po ashtu edhe adhurimi ka edhe kohën e vet të caktuar.

Fetvaja nuk dallon nga adhurimet e tjera. Ajo zotëron në vetvete kushtet e saj, shtyllat e saja, vaxhibet, sunetet, etikën e saj, një gjë të tillë e di kushdo që e di se çfarë do të thotë fetva, si dhe çdokush që ka frikë Allahun kur e jep atë.

Ai që merr përsipër të japë fetva, mirëpo nuk i plotëson kushtet e saj është si shembulli i atij që falet pa abdes, edhe nëse kjo vepër në shikimin e njerëzve duket e vlefshme, por ky person llogaritet si mëkatar.

Krejt këto korniza që i cekëm janë në kundërshtim me atë që thuhet liria në fetva, për ata që shpifin për fetvanë, duke i shpërfillur kushtet dhe kufizimet e fetvasë. Gjithashtu këtu do të cekim një çështje me rëndësi, e cila harrohet nga ata që japin fetva e ajo është urtësia në qartësimin e dijes dhe të ketë parasysh masën së cilës i drejtohesh, kështu që në qoftë se njerëzit janë të pajtimit me një fetva të saktë, nuk është prej urtësisë a as prej fesë që të vish me diçka që e kundërshton atë dhe sjell çrregullime e trazirë në trurin e njerëzve me një mendim të cilin ai mund ta ketë, ku me të e kundërshton masën, prandaj në këtë rast tregojë mendimin tënd vetëm atij që të pyet; përgjigju atij në qoftë se je prej atyre që mund të bëjnë ixhtihad, mirëpo duke pasur kujdes të mos i tronditësh njerëzit dhe të hysh në zënka me njerëzit. Kjo vlen për dikë, i cili i plotëson kushtet për të


“...Lënia e disa suneteve është më prioritare, se sa të vepruarit me ta, kur e sheh muftiu të arsyeshme...”

“...Ai që merr përsipër të japë fetva, mirëpo nuk i plotëson kushtet e saj është si shembulli i atij që falet pa abdes...”

dhënë fetva, për këtë çështje ka shumë raste nga selefi ndoshta ato më gjerësisht do t'i cekim ndonjëherë tjetër. Kjo punë ka arritur tek dijetarët e selefit në atë gjendje, sa që disa prej tyre kanë thënë: Ndonjëherë prej sunetit është lënia e një suneti. Këtë gjë e ka sqaruar Shejhul Islam Ibën Tejmije në Kavaidul Nuranijeh, ku sqaron se lënia e disa suneteve është më prioritare, se sa të vepruarit me ta, kur e sheh muftiu të arsyeshme. Në qoftë se e shfaq një gjë të tillë e ajo të çon në përçarje dhe zhurmë, ai, Allahu e mëshiroftë thotë duke folur për besmelen në namaz: “Është e pëlqyeshme për njeriun t'i lejë këto të pëlqyera (sunete), me qëllim që t'i zbuten zemrat njerëzve, sepse dobia e zbutjes së zemrave në fe llogaritet se është më e madhe, se sa vetë vepra në fjalë, ashtu siç e la Profeti *sal-lallahu alejhi ue selem* rindërtimin e Qabesë sipas themeleve të Ibrahimit *alejhi selam*, ngase vërejti se një gjë e tillë i mban zemrat të bashkuara. Po ashtu i njëjti rast ka ndodhur me Ibën Mesudin *radijallahu anhu*, i cili nuk u pajtua dhe e qortoi Osmanin, *radijallahu anhu*, i cili e plotësoi namazin në udhëtim, mirëpo prapëseprapë e plotësoi namazin bashkë me të dhe tha kur u pyet për një veprim të tillë: “**Kundërshtimi (hilafi) është sherr (i keq)**”.

Ashtu siç është kundërshtimi sherr në tekstin e Ibën Mesudit r.a., po ashtu ndërrimi i bisedës për të qenë rob i përkushtuar ndaj Allahut në bisedën e lirisë së dhe trumbetimit të saj është gjithashtu sherr. Allahu qoftë në ndihmë! ■

Nga arabishtja: Nexhat Ceka



SHKRUAN: RASHIT ZYLFIU

Falënderimet i takojnë të madhit Zot që krijoi njerëzimin. Ai e ndau llojin njerëzor në mashkull dhe femër **“Dhe Ai është që krijoi llojet - mashkullin dhe femrën.”**¹ Për të dhënë kontributin në jetën e kësaj bote çdo njëri nga këndi i tij. Feja nuk bën dallime mes mashkullit dhe femrës përveç në disa dispozita në bazë të natyrshmërisë së këtij lloji njerëzor. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”**²

Caktimi hyjnor e përcakton dallimin mes

llojit njerëzor mashkull dhe femër **“...E mashkulli nuk është si femra.”**³ dhe këto dallime i argumenton sheriat, mendja e shëndoshë dhe shkenca. Sheriati islam parasheh disa dispozita që femra dallohet me to nga mashkulli dhe këto duke u mbështetur në bazë të nevojës së natyrshmërisë së këtij lloji njerëzor. Njëra nga këto dispozita është hixhabi apo mbulesa.

Mbulesa në kuptimin e gjerë:

Hixhabi në kuptimin e gjerë do të thotë: pengesë, mbulim. Mbulesa është detyrim për çdo mashkull dhe femër. Mashkull me mashkull, femër me femër apo anasjelltas. Mashkullit i detyrohet t’i mbulojë pjesët e trupit nga kërthiza e deri në gjunjë, qoftë në prezencën e meshkujve apo femrave përveç

¹ Nexhm, 45.

² Nahl, 97.

³ Ali Imran, 36.

gratë, që ai i ka nën kurorë. Islami i urdhëron besimtarët dhe besimtare ta ulin shikimin nga këto pjesë të trupit, të cilat ngjallin epshin. Kjo është etika e sheriatit, që e largon nefsën për të mos rënë në haram.

Mbulesa në kuptimin e ngushtë:

Islami i detyron të gjitha gratë besimtare, që të mbulohen me mbulesën islame nga koka e deri tek këmbët, duke mbuluar kokën dhe trupin e tyre dhe stolitë që ato zotërojnë nga çdo burrë i huaj. Kjo duke u bazuar në Kuran, Sunet dhe konsensusin praktik prej grave besimtare nga koha e Pejgamberit paqja dhe lavdërimi i Allahut qoftë mbi to, e duke kaluar në periudhën e kalifatit dhe brez pas brezi deri në kohën tonë.

Përkufizimi i hixhabit, mbulesës: Mbulesa në aspektin gjuhësor sillet rreth kuptimit: pengesë, mbulim.

Mbulesa në aspektin e sheriatit:

Mbulimi i gruas, trupit dhe stolive të saj, që i pengon burrat e huaj të shohin diçka nga trupi apo stolitë me të cilat zbukurohet ajo. Kjo mbulesë arrihet me petka apo duke qëndruar në shtëpi. Mbulimi i stolive, është mbulimi i të gjitha stolive, që femra i vendos për t'u zbukuruar. *"...të mos zbulojnë stolitë e tyre..."*⁴.

Me çfarë duhet të jetë hixhabi, mbulesa?

Hixhabi përbëhet nga dy gjëra:

Një: Hixhabi duke qëndruar në shtëpi; ngase kjo ia mundëson femrës, që të largohet nga shikimet e meshkujve të huaj dhe përzierjes me ta.⁵

Dy: Hixhabi me petk, që femra duhet të

mbulojë të tërë trupin e saj me përjashtim të fytyrës dhe duarve.

Kushtet e hixhabit, mbulesës sipas sheriatit islam:

Në bazë të ajeteve kuranore, haditheve të Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe gjurmëve të **të parëve tanë të mirë** na sqarohet, se femra nëse del nga shtëpia e saj detyrohet ta mbulojë tërë trupin e saj dhe stolitë përveç fytyrës dhe duarve⁶ me çfarëdo petku duke përmbysh këto kushte⁷:

Mbulimi i tërë trupit përveç fytyrës dhe duarve.

Që petkat mos të jenë të zbukuruar.

Mos të jenë të tejdukshme.

Të jenë të gjera, mos të jenë të ngushta.

Mos të jenë të parfumuara.

Mos t'i përngjasin veshjeve të burrave.

Mos t'i përngjasin veshjeve të jobesimtareve.

Mos të jenë nga veshjet shuhreh⁸.

Argumentet e detyrimit të hixhabit, mbulesës për gratë besimtare:

Argumentet për detyrimin e hixhabit, që janë të përvetshme për të gjitha gratë besimtare janë përmendur në dy ajete në suret Nur dhe Ahzab. Argumenti i parë:

*"O gratë e Pejgamberit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër, nëse kini kujdes e ruheni, prandaj mos u llastoni në të folur e të lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, po thoni fjalë të matura. Dhe rrini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj si shfaqej në injorancën e hershme..."*⁹ Ky ajet iu drejtohet grave të Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, për shkak të pozitës dhe

⁴ Nur, 31.

⁵ Kjo nuk do të thotë se Islami e ndalon femrën të dalë nga shtëpia, por Islami ka përzgjedhur shtëpinë për dobinë e saj e në rast se ajo ka nevojë për t'i kryer detyrat e saj i lejohej të dalë nga shtëpia si për blerje, mjekime apo vizita të familjarëve të saj etj.

⁶ Nëse femra dëshiron t'i mbulojë fytyrën dhe duart e veta ajo praktikon kështu një sunet të Nënave të Besimtareve.

⁷ Shih "Xhilbab mer'eh muslimë" Nasirudin Albani.

⁸ Me fjalën Shuhre, kihet si qëllim veshjet, që nuk janë traditë e atij vendi dhe që banorët e atij vendi nuk e veshin zakonisht.

⁹ Ahzab, 32-33.

afërsisë së tyre me Pejgamberin *sal-lallahu alejhi ue selem*, por i përfshin të gjitha gratë e besimtarëve.

Argumenti i dytë: “Ajeti i hixhabit, mbulesës”:

“O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit ndryshe, vetëm nëse u lejohet për ndonjë ngrënie e duke mos pritur përgatitjen e saj, por kur të thirreni, atëherë hyni, e kur të jeni ushqyer, atëherë shpërndahuni, duke mos hyrë në bisedë me njëri-tjetrin, vërtet këto (pritja, qëndrimi, biseda) *e mundojnë Pejgamberin, por ai turpërohet prej jush; Allahu nuk i turpërohet realitetit. E kur kërkonit prej tyre* (grave të Pejgamberit) *ndonjë send, atë kërkojeni pas perdes, kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të tyre. Juve nuk ju takon ta mundoni të Dërguarin e Allahut, e as të martoheni kurrë me gratë e tij, pas* (vdekjes së) *tij. Këto janë tek Allahu mëkat i madh. E shprehët ju haptazi ose fshehtazi ndonjë send, s’ka dyshim se Allahu çdo send e di. Nuk është mëkat për ato* (gratë të jenë të pambuluara) *ndaj etërve të tyre, as ndaj djemve të tyre, as ndaj vëllezërve të tyre, as ndaj djemve të vëllezërve të tyre, as ndaj djemve të motrave të tyre, as ndaj grave të tyre, e as ndaj robërshave të tyre. E, frikësohuni* (o ju gra) *Allahut, Allahu është pranë çdo sendi.*” Ky ajet njihet si ajeti i hixhabit, ngase e ka bërë detyrim hixhabin për Nënata e Besimtarëve dhe grave të besimtarëve. Ka zbritur në muajin Dhul Kade në vitin e pestë të hixhretit.

Shkaku i zbritjes së këtyre ajeteve:

Na përcillet nga hadithi i Enesit, Allahu qoftë i kënaqur ndaj tij, se ka thënë: Omeri, Allahu qoftë i kënaqur ndaj tij ka thënë: I thashë: “O i Dërguari i Allahut, tek ty hynë i miri dhe i keqi, sikur t’i urdhëroje Nënata e Besimtarëve (gratë e tua) të mbulohen.

“Katër medhhebet, Hanefi, Maliki, Shafiji, Hanbeli kanë rënë në pëlqim, se femra muslimane është e detyruar ta mbulojë të tërë trupin e saj nga burrat e huaj...”

Atëherë Allahu i Madhëruar zbriti ajetin e hixhabit, mbulesës.” (Shënon Ahmedi dhe Buhariu). Kur zbriti ajeti i mbulesës Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* i mbuloi gratë e tij nga burrat e huaj dhe besimtarët i mbuluan gratë e tyre, duke i mbuluar nga koka e deri tek këmbët dhe stolitë e tyre. Mbulesa është detyrim i përgjithshëm për çdo besimtare nga mosha e pubertetit dhe është detyrim i përjetshëm deri në Ditën e Kiametit.

Argumenti i tretë: *“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t’i vënë shamitë* (mbulojë) *e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen* (se nuk janë rrugaçe) *e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues.*”¹⁰ Sujuti Allahu e mëshiroftë thotë: “Ky është ajeti i mbulesës dhe është për të gjitha gratë...”

Argumenti i katërt: *“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet* (prej haramit), *t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, se kjo është më e pastër për ta. Allahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç*

¹⁰ Ahzab, 59.

burrave të vet, baballarëve të tyre, ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre dhe robërshave, të cilat i kanë nën pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt, të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat, ose fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.”¹¹

Allahu subhanehu ue teala i ka urdhëruar gratë e besimtarëve, që të mbulohen me një petk, i cili mbulon të tërë trupin dhe bukuritë e tyre para burrave të huaj, duke e llogaritur një gjë të tillë adhurm; shpërblehet nëse e vepron dhe ndëshkohet nëse nuk e vepron (nuk mbulohet). Prandaj zbulimi ka qenë nga gjërat e ndaluara (haram), e cila të shpie drejt mëkateve të mëdha, si përziera me burra dhe sprovimi i të tjerëve. Gratë e besimtarëve duhet t'i përgjigjen ajetit dhe të ecin sipas asaj që i ka urdhëruar Allahu subhanehu ue teala, duke u mbuluar me mbulesën islame dhe duke qenë të ndershme, për t'iu nënshtruar Allahut subhanehu ue teala dhe të Dërguarit të Tij.

Argumenti i pestë: Justifikimi i grave të moshuara për ta hequr hixhabin, mbulesën.

“E gratë e moshuara, të cilat nuk dëshirojnë martesë më, për to nuk është mëkat ta heqin petkun mbulues të tyre, po duke mos qenë zbuluese të bukurive, megjithëqë më së miri është për to të jenë të përmbajtura. Allahu dëgjon, di.”¹² Allahu i Madhëruar i ka justifikuar gratë e

moshuara, të cilave ju është ndërprerë cikli menstrual dhe lehonja dhe të cilat nuk lindin, që ta heqin petkun-hixhabin me të cilin kanë qenë të detyruara më herët. Ky justifikim është i lejuar me dy kushte:

Kushti i parë: Që gratë e moshuara të jenë nga ato të cilave nuk u ka mbetur bukuria apo kanë humbur shpresën për kurorë.

Kushti i dytë: Që mos t'i shpalesin stolitë e tyre.

Argumentet nga Suneti:

Argumentet nga udhëzimi profetik janë të shumta, që aludojnë për detyrimin e mbulesës.

Një: Përcillet nga nëna e besimtarëve Aishja Allahu qoftë i kënaqur ndaj saj, se ka thënë: “Njerëzit kalonin pranë nesh e ne ishim me Pejgamberin *sal-lallahu alejhi ue selem*, ishim në ihram¹³, kur burrat u afronin afër nesh lëshonim vellon mbi fytyrat tona e kur iknin i zbulonim ato.” (Ahmedi, Ebu Daudi, Ibën Maxhe.)

Dy: Përcillet nga Umu Atije Allahu qoftë i kënaqur ndaj saj, se ka thënë: Kur Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, urdhëroi që edhe gratë të dilnin për faljen e namazit të bajramit ato i thanë: O i Dërguari i Allahut, njëra nga ne nuk ka xhilibab “petk për mbulim”. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* tha: “*Le ta veshë xhilibabin*”¹⁴ e motrës së saj.” (Buhariu, Muslimi)

Tre: Përcillet nga Aishja Allahu qoftë i kënaqur ndaj saj, se Esma bint Ebu Bekër Allahu qoftë i kënaqur ndaj saj dhe babait të saj, kur hyri tek Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* kishte veshur rroba të holla. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* i tha: “*Oj Esma! Femra kur të arrijë moshën e pubertetit nuk i lejohet t'i shihet përveç*

¹¹ Nur, 30-31.

¹² Nur, 60.

¹³ Ihram, veprim që bëhet gjatë kryerjes së haxhit.

¹⁴ Xhilibab, lloj petku që e mbulon të gjithë trupin.

kësaj." Dhe aludoi tek fytyra dhe duart. (Ebu Daudi)

Qëndrimi i medhhebeve ndaj hixhabit :

Katër medhhebet, Hanefi, Maliki, Shafiji, Hanbeli kanë rënë në pëlqim, se femra muslimane është e detyruar ta mbulojë të tërë trupin e saj nga burrat e huaj. Pa marrë parasysh se a e llogarisin, se duhet të mbulohet fytyra dhe duart apo jo.

Dijetarët kanë rënë në ujdi, se gratë duhen të mbulohen nga burrat e huaj. Ibën Haxheri Allahu e mëshiroftë ka përcjellë nga Ibën Mundhiri Allahu e mëshiroftë. "Kanë rënë në ujdi, se gruaja e cila është në ihram të veshë rroba të qepura..."

Kjo është argument për atë që është në ihram gjatë kryerjes së haxhit, e ajo e cila nuk është në ihram për te është edhe më e detyruar.

Hixhabi, mbulesa ka qenë njëra prej shenjave me të cilën janë dalluar gratë besimtare në të gjitha kohët.

Ibën Tejmije Allahu e mëshiroftë ka thënë: "Ka qenë rrugë e besimtarëve në kohën e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, që gruaja të mbulohet..."

Imam Ibën Reslani Allahu e mëshiroftë ka thënë: "Muslimanët kanë rënë në ujdi, që të pengohet gruaja të dalë e pambuluar."

Referencat e konsultuara:

Audetul hixhab, Muhamed ibën Ahmed Ismail.

Hirasetul fadileh , Bekër ibën Abdullah Ebu Zejd.

Hixhabul mer'etil muslimë, Nasirudin Albani. ■

INVESTIMI NË ISLAM

E pasuria është ndër elementet kryesore për rimëkëmbjen e umetit, për atë i Dërguari i Allahut (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin me të) ka thënë: "Nuk më ka bërë dobi asgjë, sa më ka bërë dobi pasuria e Ebu Bekrit, atëherë ai qau e tha: Unë dhe e tërë pasuria jemi të tuat, o i Dërguari i Allahut

PËRPUNOI: LLOKMAN HOXHA

Investimi në ekonomi ka më shumë se një përkufizim, por qëllimi në këtë temë është kuptimi i përgjithshëm i investimit, që është shfrytëzimi i parasë për të gjeneruar para të tjera, ose e thënë ndryshe për të arritur fitimin. Investimi përbëhet nga tri elemente që janë:

1-**Investitori**, në esencë investimi bëhet nga vetë pronari i parave, por ai mund të bëhet edhe nëpërmjet një personi tjetër të autorizuar nga pronari, si dhe personi mund të jetë fizik dhe juridik.

2- Pasuria për t'u investuar. Për të qenë investimi i drejtë duhet të jetë në pronësi të plotë të investitorit, përndryshe nuk është i lejuar përveç me lejen e pronarit.

3- Sfera e investimit. Për të qenë investimi i plotë duhet të ketë patjetër sferën në të cilën bëhet investimi, qoftë ai në bujqësi, tregti, industri etj., si dhe duhet të jetë në pajtueshmëri



“Allahu i Lartësuar na tregon se pasuria është mëkëmbje për shoqërinë islame, e kjo do të thotë se shoqëria nuk mund të ngrihet e as të lëvizë pa të...”

ka konsideruar këto si detyrim (vaxhib), apo qoftë edhe si detyrim alternativ (vaxhib tahjiri) për ata që i plotësojnë kushtet, që do të thotë se së paku njërën nga këto obligohet ta zbatojë, sikurse qëndron çështja me obligimet alternative të njohura në lëminë e jurisprudencës islame.

2- Është e njohur në jurisprudencën islame, se gjërat të cilat për t'u kujdesur për to kanë motive natyrale (si dashuria ndaj pasurisë dhe shtimit të saj) konsiderohen prej gjërave të lejuara, dhe nuk i përkasin detyrimeve përveç në raste të caktuara, kur njeriu mund t'i shmanget natyrshmërisë së vet.

Mendimi i dytë:

Investimi konsiderohet si detyrim në tërësi, që do të thotë se nuk lejohet për umetin musliman ta lërë anash, e të mos merret me të në tërësi. I këtij mendimi është Ali el-Karadagi⁴

Argumentet:

1- Fjala e Allahut: **“Mendjelehtëve (të papjekurve) mos u jepni pasurinë tuaj, që Allahu e bëri për ju mëkëmbje, e ata ushqeni me të, vishni dhe u thoni fjalë të mira.”** (Nisa: 5).

Allahu i Lartësuar na tregon se pasuria është mëkëmbje për shoqërinë islame, e kjo do të thotë se shoqëria nuk mund të ngrihet e as të lëvizë pa të, si dhe fjala e Tij **“e ata**

me rregullat e Fesë Islame.¹

Dispozita e investimit

Argumente të shumta kemi nga Kurani dhe Suneti, të cilat inkurajojnë investimin e pasurisë dhe rritjen e saj, si dhe për kujdesin ndaj hallallit, gjë e cila konfirmon legjitimitetin e investimit. Por dijetarët muslimanë kanë disa mendime rreth dispozitës së investimit, ku do të veçoja dy prej tyre, ato më kryesoret.

Mendimi i parë:

Investimi në esencë i përket dispozitës së lejimit (mubah), mirëpo është prej çështjeve të cilat mund të trajtohen edhe në pesë dispozitat e sheriatit² varësisht nga rrethanat, por dominon dispozita e preferimit (mendubi), duke u bazuar në shumë citate të konsiderueshme. I këtij mendimi është AbduSetar Ebu Gudeh.³

Argumentet:

1-Të gjithë dijetarët janë të pajtimit, se dispozita bazë e shitblerjes, qirasë, partneritetit e të ngjashme është lejueshmëria, ngase askush prej tyre nuk i

¹ El-hiti, Kasr AbdulKerim, Esalibu l-istithmar ue etheruhu ala l-esvak el-malije, fq. 26.

² Pesë dispozitat e sheriatit janë obligimi (farz-vaxhib), e preferuara (mendub), e lejuara (mubah), e ndaluara (haram) dhe e urrejera (mekruh).

³ Ebu Gudeh AbduSetar, El Istithmar fil es'hum, bahth fi mexheletu l-mexhmah efikhi, v. 9, fq. 767.

⁴ El-Karadagi, Ali hukmu l-istithmar fil es'hum fq.17, Sano Kutub, El-istithmar ve ahkamuhu fq. 34.

ushqeni me të", që sipas Raziut duke komentuar këtë ajet thotë: Allahu nuk e ka përdorur shprehjen (ushqeni nga ajo "minha"), por (ushqeni me të "fiha"), ashtu që mos të mendohet se nga urdhri për furnizim kuptohet, se qëllimi është që vetëm një pjesë e pasurisë së tyre duhet të jetë furnizim për ta. Por Ai ka urdhëruar, që e tërë pasuria e tyre të jetë pjesë e furnizimit për ta, duke bërë tregti me të (pasurinë), duke investuar gjë që furnizimi duhet të jetë edhe prej fitimit e jo vetëm nga kapitali.⁵

2- Fjala e Allahut: **"Që ajo (pasuria) të mos mbetet (vetëm) ndërmjet pasanikëve tuaj."** (Hashr: 7), që do të thotë se për të mos mbetur pasuria vetëm në duar të disa të pasurve, atëherë ajo bëhet me dhënie të lëmoshës, ose me investime, të cilat sjellin përfitimet për të gjithë, punëtorët, prodhuesit, tregtarët e kështu me radhë.

3-Fjala e Allahut: **"Ai së pari ju krijoi nga dheu dhe ju bëri banues të tij."** (Hud:61), fjala e Allahut **"banues"** ka kuptim gjallërues, shfrytëzues, pra, kjo është një thirrje hyjnore për ndërtimin e tokës dhe zhvillimin e saj përgjithësisht, e kjo arrihet vetëm duke shfrytëzuar dhe investuar në të mirat, që i ka krijuar Allahu për njeriun.

4- Enesi tregon, se i Dërguari i Allahut (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin me të) ka thënë: **"bëni tregti me pasurinë e jetimëve, të mos e harxhojë zekati."**⁶

Ky hadith është argument, se obligueshmëria e zekatit të pasurisë i motivon pronarët e saj, që të bëjnë tregti, ngase nëse nuk e bëjnë këtë, atëherë ajo do të harxhohet nga zekati dhe shpenzimet e bëra, gjë të cilën e vërteton edhe ekonomia bashkëkohore, e kjo tregon se duhet të bëhet tregti me pasurinë e të vegjëlve, apo atyre që

janë të paaftë për veten e tyre, si të paaftët mentalisht, mendjelehtit e ngjashëm.

5- Nga objektivat kryesore të Sheriatit Islam është ruajtja e pasurisë, e kjo nuk arrihet përveçse me anë të investimit dhe zhvillimit të saj.

6- Rregulla e fikhut që thotë: **"Ajo me të cilën mundësohet arritja e vaxhibit vetëm se me anë të saj, bëhet vaxhib."**⁷

Pra, investimi është detyrim kolektiv (farz kifaje), ku umeti detyrohet të merret me investime, që të shtohet pasuria, të largohet papunësia, dhe le të arrihet mjaftueshmëria për të gjithë në rast se nuk mund të realizohet pasurimi i të gjithëve.

Mendimi më i saktë:

Ajo që mund të kuptohet nga argumentet e paraqitura nga të dy palët tregon se mendimi i dytë është më i saktë, sidomos kur edhe mendimi i parë mund të kalojë në mendimin e dytë pasi që përmendëm, se mendimi i parë e lidh dispozitën me rrethana, e ne e dimë, se në kohën e sotme është më se e domosdoshme, që muslimanët të arrijnë sa më shumë pasuri individuale dhe kolektive, që zgjimi i umetit dhe lëvizja e tij të përshpejtojë dhe të marr kahen e duhur.

E pasuria është ndër elementet kryesore për rimëkëmbjen e umetit, për atë i Dërguari i Allahut (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin me të) ka thënë: **"Nuk më ka bërë dobi asgjë, sa më ka bërë dobi pasuria e Ebu Bekrit,** atëherë ai qau e tha: Unë dhe e tërë pasuria jemi të tuat, o i Dërguari i Allahut."⁸ E gjitha kjo sepse ishte më se e nevojshme në fillimet e Islamit një mbështetje e fuqishme financiare.

Në vijim do të lexoni objektivat e investimit dhe rregullat e tij në Islam ■

5 Er-Razi, Fahrudin, Mefatihul l-gajb, v. 9, fq. 193.

6 Taberaniu fil Evsat, Hejthemiu thotë: Me ka thënë hoxha im (h. El-Iraki) isnadi i hadithit është i saktë.

7 El-fetuih, sherh el-kevkebu l-munir, v. 1, fq. 357.

8 E përcjell Ahmed, Shuajb Arnauti e vlerëson të saktë



HIXHABI AKTI I BINDJES

Gjithçka e vlefshme dhe e shtrenjtë, arritja e së cilës është e vështirë, gjithherë e gjejmë të mbuluar, realisht asaj s'i përket të ekspozohet, ngase rrjedhimisht kuptimi dhe vlera e saj zbehet. Të këtij shembulli janë edhe xhevahiret

SHKRUAN: DRITA MALIQI

Po pra, në të vërtetë hixhabi paraqet një akt bindjeje. Argumente sheriatike për obligueshmërinë e hixhabit dhe normat e saj i gjejmë shumë të qarta në Kuranin Famëmadh dhe nga burime të besueshme e të sakta profetike. Ato argumente shuajnë çdo zë të ngjirur, se gjoja urdhërimi për mbulesën islame është i paevidentueshëm në shkrimet e shenjta!

Islami na mëson për të qenë të drejtë, të sinqertë dhe të dëgjueshëm ndaj urdhrave të Allahut. Sakaq kushtëzohemi që për të qenë besimtarë të sinqertë gjithsesi atë çfarë e besojmë dhe e flasim ta jetësojmë në praktikë. Në pajtueshmëri me këtë, kësisoj duhet që hixhabi të jetë reflektim i imanit, pra kurorëzim ndaj kryerjes së urdhrit të Allahut. Keni dëgjuar të thuhet: “Mbulesa më ka ndryshuar!”; “Tani ndihem e

kompletuar!”; “Ah! Sikur ta kisha vendosur që moti!”; “Tanimë jam më e qetë!”; “Ndihej e mbrojtur dhe më afër Allahut!”. Kështu shprehen motrat tona muslimane pasi e kanë vënë në praktikë publikisht mbulesën. Me të vërtetë një kënaqësi e rrallë e përjetuar vetëm nga ato të cilat hixhabin islam e vendosin si dëgjueshmëri ndaj urdhrave të Allahut të Plotfuqishëm. Në të vërtetë kryerja e çdo ibadeti e ka në vetvete atë kënaqësi e afërsi me Allahun, këto ndjenja imanore, që as për së afërmi nuk paramendohen, pa i bërë apo pa i praktikuar vetë.

Cilësitë e hixhabit

Hixhabi është modesti e çiltërsi, gjithashtu paraqet siguri e qetësi. Po, është nder e identitetit i femrës; Allahu i Lartësuar thotë në ajetin kuranor: *“O pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t'i vënë vellot e veta mbi*

trupin e tyre, sepse kjo është më afër që ato të njihen, se nuk janë rrugaçe e të mos ofendohen". (Ahزاب: 59).

Nder, mbrojtje dhe pastërti për femrën. Me të femra ruan dinjitetin e vet e prirë nga xhelozia se trupi që bart shpirtin është çështje personale e saj. Ajo shquan veten për vlerën që ka dhe ruan femëroren e saj. Gjithçka e vlefshme dhe e shtrenjtë, arritja e së cilës është e vështirë, gjithherë e gjejmë të mbuluar, realisht asaj s'i përket të ekspozohet, ngase rrjedhimisht kuptimi dhe vlera e saj zbehet. Të këtij shembulli janë edhe xhevahiret. E aq më shumë, që një femër e mbuluar zbukurohet me petkun e devotshmërisë. Brendësinë e këtij petku, respektivisht urtësitë e hixhabit ajo do t'i përfjetojë në çdo hap që hedh dhe sa herë që frymon. Allahu i Lartësuar thotë: ***"O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ju mbulon vendturpësinë dhe petk zbukurues. Por petku i devotshmërisë ai është më i miri. Këto janë nga argumentet e Allahut, ashtu që ata të përkujtojnë"***. (Araf, 26). Hixhabi reflekton turpin që buron nga imani i muslimanes, turpi cilësi kjo e rrënjësuar në natyrën femërore. I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: *"Turpi dhe imani janë të pandarë. Nëse njëri ngrihet, ngrihet edhe tjetri"*.¹ Pas gjithë kësaj rrëfjeje për ato që përjeton besimtarja për hixhabin e saj, që madje për të është mu sikur lëkura e saj, duke i shtuar kësaj që atë e konsideron vlerë dhe ushqim për vete, vallë, me ç'të drejtë të përfliten ato, që kinse qenkan të shtypura, të prapambetura etj...

Hixhabi në shoqërinë tonë

Për një femër muslimane praktikante e sistemit jetësor islam, hixhabi assesi nuk paraqet për të një mbulim si pasojë e një dhune a imponimi. Hixhabi është zgjedhja e saj. Ajo madje mbulesën e saj e do, po edhe

“Të shumta janë rastet ku stërzgjatet mbulimi nën pretekstin, se akoma duhet mësuar feja, justifikim ky që s’është tjetër pos cytje nga djalli...”

nëse ka pak ose shumë dije. Ajo është pjesa e saj. Në shoqëri shpeshherë për të mos thënë gjithnjë, vendimit për t'u mbuluar i ngjiten shumë paragjykime nga të tjerët, vallë a e ka bërë me dëshirë, a është e detyruar nga të tjerë, etj.

Në njërin prej Instituteve të Universitetit (në Maqedoni) aty ku bëj studimet e mia, vend ky ku s'ka të punësuar, as muslimanë e as shqiptarë, aty ku unë jam pakicë e dyfishtë (shqiptare dhe muslimane e mbuluar), gjen të punësuar si hulumtuese një grua në moshë të mesme, e cila pas një periudhe orvatjesh mezi kishte gjetur mundësinë për të hyrë në shoqëri me mua, që paskëtaj të bisedojë disa halle. U bë e u njoftuam aty. Ajo nuk ngurroi që në bisedat e para të shprehi respektin për mbulesën time. Kjo grua kishte një hall të madh. Ajo vuante nga një sëmundje, për të cilën barnat nuk mjaftonin si mjet kurues, por duhej sipas rekomandimit mjekësor një terapi që ishte mbulimi i kokës. Realisht ajo nuk kishte dert ta mbante këtë shami koke. Halli i saj prej një gruaje qytetare me një kulturë të lartë ishte se mos vallë kur ajo ta vendosi shaminë, me të cilën dallohen femrat muslimane, ajo në rregullimin e saj bën gabime dhe si rrjedhojë të ofendohen ai grup shoqëror që mbulohen në këtë formë, e kjo të bëhet shkak e ato të përqeshen. Dhe nga unë kërkonte t'ia mësoj vënien e saktë të

¹ Sahihul Xhamië nr. 1603

shamisë, e rrjedhimisht të ketë ndërgjegje të qetë, që me mbulimin e kokës së saj nuk ka dëmtuar askënd. Ja kjo është një grua jomuslimane, i përket fesë së krishtere ndaj cilës është e përkushtuar dhe hëpërhë vini në konsideratë vetëdijen e saj të lartë qytetare që ka tek dëshiron respektimin e një kodi veshjeje. Nga ky rast çdo femër muslimane, e cila nuk respekton porosinë islame për t'u mbuluar duhet të nuhasë aromë kthjellje, që të mos i errësohet vetëdija, e të bëhet e pakujdesshme mbi rregullin shariatik për mbulesën.

Do të mbulohem, por...

Të shumta janë rastet ku stërzgjatet mbulimi nën pretekstin, se akoma duhet mësuar feja, justifikim ky që s'është tjetër pos cytje nga djalli. E gjen të thotë nuk jam e gatshme. Shquajeni veten, -i këshillojmë-, bëjini ballë sfidave e mësoni fenë duke mbajtur hixhabin, këtë kurorë që mbajnë kokat krenare. Sikundër se ka këso arsyetimesh, ka edhe ndjenja inferioriteti, sikleti... I këshillojmë me fjalën e Profetit: **"Kush mundohet ta kënaqë Allahun, duke i hidhëruar njerëzit, kënaqet Allahu prej tij dhe e bën që edhe njerëzit të kënaqen prej tij; kurse kush mundohet t'i kënaq njerëzit duke e hidhëruar Allahun, Allahu hidhërohet me të, e gjithashtu edhe njerëzit hidhërohen me të"**. Largoje këtë ngërç që po të lodh, po të ndal nga punët, po të plogështon, po t'i rrënon synimet, po ta shemb vetëdijen që ke në këtë shteg që për shtegtarët e saj mbrapa s'ka, po t'i këput këmbët për të bërë hapin drejt realizimit të asaj, që je urdhëruar për të nga Ai që është më i Madhi. Merr mësim nga motrat tona të kthyera në Islam, të cilat pa kurrfarë hezitimi në ditët e para apo mu në çastet e shqiptimit të shehadeit mbulohen. As unë nuk po hezitoj të shkoqis diçka nga tregimet e tyre.

Umu Tarik, një maqedone muslimane e

konvertuar në vendin tonë, na rrëfen për vështirësitë e saj nëpër të cilat kaloi deri tek arritja e mbulesës, vështirësi këto me familjen, me të afërmit po gjithashtu edhe me rrethin e saj, të cilët nuk e prisnin diçka të tillë nga ajo. Ajo si ish-e krishtere e përkushtuar e tani një muslimane e kompletuar i kishte paraqitur familjes së saj argumente e shembuj nga Bibla, por këto atyre nuk u mjaftonin, ngase sipas tyre tani më koha është ndryshe. Por mbi të gjitha frikërespekti ndaj Allahut dhe dëshira për ta kryer edhe këtë farz që i mungonte, e kishte afruar dhe forcuar atë edhe më tepër drejt mbulesës. Ndërsa kur flet për hixhabin e saj, ajo me plot mburrje dhe siguri flet: *"Ndjenjë e çuditshme e mbrojtjes!"*. Për këtë ajo kishte rrezikuar punën e saj si profesoreshë, prej ku u largua. Mirëpo pas vështirësive ajo tani gëzon respektin e familjes së saj për hixhabin e saj, bile tanimë në familjen e saj ajo nuk është e vetmja muslimane. Jini realistë e gjykoni, vallë cilat motra e kanë më të vështirë, ato që jetojnë në familje muslimanësh, apo ato që janë muslimane të vetme në familje?

Le t'i kushtojmë pak vëmendje qëndrimit të psikologes Lule Uka Dalipi, një qëndrim ky sublim, që flet me gjuhën e kthjelltësisë: *"Mbulesa veçse është bërë vlerë e imja, vlerë e cila është mbjell në shpirtin tim dhe doemos kur vlara bëhet e fuqishme reflektohet edhe jashtë, duke tejkaluar sfidat dhe paragjykimet injorante të shoqërisë, e tillë është edhe dashuria ime për të, me të kam kompletuar personalitetin tim të një muslimaneje, e cila dëshiron të gjykohej në bazë të vlerave dhe mendimeve të saj e jo në bazë të pamjes së jashtme"*. Me zbatimin e këtij urdhri të Allahut ajo synon të ndërveprojë në rrethin social në mënyrë më dinjitoze.

Gjithashtu edhe motrat tona që mbulohen në moshë shumë të re kanë pasur

sfidat e veta. Brunilda Basha, na tregon pikërisht për këtë. *“Jam e mbuluar që në moshë 13 vjeçare dhe kisha raste në autobusë kur njerëzit më flisnin mbi të me shumë përçmim... çuditërisht nuk e pata kurrë problem përkundrazi u gëzoja shumë pasi më jepej rasti të bëja dave tek ata njerëz...”*. Ajo tani po vazhdon studimet e mëtejshme në shkenca arkitekturore, në një vend islam, ku për dallim nga vendi i saj hixhabi është gjëja më normale, meqë shumica janë të mbuluara. *“..duke patur kontakte të larmishme me vajzat nga e gjithë bota dhe fe të ndryshme më bën ta dua veshjen time çdo ditë e më shumë”* – thotë ajo.

Hixhabi im: bindja ime, identiteti im, vlera ime

Vallë, a keni menduar ndonjëherë pse pas aq shumë sfidave dhe sprovave ndaj motrave me hixhab, dashuria dhe qëndrimi kundrejt hixhabit vetëm forcohet e assesi nuk merr tatëpjetën?! Vrite kokën, vallë a s'ua provokon intelektin ky fakt! Pavarësisht pengesave e vështirësive, mbulesa për muslimanen mbetet në visarin e saj, që e ruan me xheloz. E si të mos jetë kështu, kur ajo e adhuron Allahun me hixhab, afrohet tek Ai duke iu bindur, i ngrihet imani me mbajtjen e kësaj veshjeje modeste dhe gjithmonë strehohet tek Allahu nga sulmet, injoranca dhe padrejtësitë që i bëhen.

Çfarë do të thotë mbulesa për ne?! Pse brengosemi aq shumë për mbulesën?! Mbulesa mbi të gjitha është nënshtrim ndaj Krijuesit tonë. *“Është një dhunti prej dhuntive të mëdha, që më bën të ndjem e lirë, e mbrojtur dhe krenare që barti mbrojtësen e nderit tim, dhe që ve në zbatim me kënaqësi të plotë urdhrin e Krijuesit tim dhe të gjithësisë”* – shpreh dashurinë dhe vlerën e mbulesës së saj Suada Zeneli, kjo infermiere dhe studente e përkushtuar. Hixhabi është në vetë identitetin dhe

“...Vallë, a keni menduar ndonjëherë pse pas aq shumë sfidave dhe sprovave ndaj motrave me hixhab, dashuria dhe qëndrimi kundrejt hixhabit vetëm forcohet e assesi nuk merr tatëpjetën?! ...”

natyrën e femrës. *“Ju betohem në Allahun, se shpirti im bashkë me gjymtyrët e trupit e kishin kërkuar, apo thënë shkurt më ishin lutur me vite të tëra për një vendim të tillë, po ja që unë iu kisha dhënë përparësi në atë kohë angazhimeve të mia si studente”* – dëfton Umu Hamza, kjo sociologe e çmuar.

Brenda saj gjenden virtytet e përjetimet më të mira. *“Hixhabi nuk është një copë pëlhure, ajo është mbrojtje, lehtësi, nder, krenari, dinjitet, liri, plotësim, prehje, qetësi. Nënshtrim ndaj të Lartmadhëruarit.”* – na thotë Burbuqe Rexha, një motër e kimisë inxhinierike e diplomuar, në koleksionin e poezive të së cilës nuk mungojnë vargjet prej poeteje të talentuar, që i thur për ndjenjat e dashurinë ndaj hixhabit.

Si përfundim

Dashuria për hixhabin është vlere jote. Kompleteje atë! Po pra, shfaqja dashurinë hixhabit, mos e mbaj në vetvete. Shprehi bindjet tuaja, shfaqë guximin tënd e prano realitetin që ti gjithsesi t'i nënshtrohesh Zotit tënd me përpikmëri. Mbulohu! Paraprakisht po ju japim një këshillë kujtdo që i bashkëngjitet karvanit të vajzave të mbuluara: Mbyllni veshët ndaj ulërimeve që të largojnë nga hixhabi! ■

GRUAJA, FAMILJA DHE EKUILIBRI I RËNDË

Ky është lloji, i cili gjendet shumë rrallë sot. Burri i këtij lloji është ai që i frikësohet Allahut, i frikësohet dënimit të Tij, dhe e urren ta takojë Zotin e Tij, duke qenë i padrejtë ndaj të dy palëve. Me urtësinë e tij, me mençurinë e tij dhe me vetëdije të plotë mundohet t'ia plotësojë të drejtat të gjithëve

SELUA EL MAGRIBI

Kur i kthehem kohëve të mëparshme më rikujtohen gjërat e mia që imagjinoja rreth pamjes së një burri, të cilin e parafytyroja në ndërgjegjen time dhe doja të ishte bashkëshorti im. Dëshiroja të ishte si babai im, i cili ishte burrë me plot kuptimin e fjalës. Por kur e bëj një krahasim mes burrit të asaj kohe dhe atij të sotmit vërej dallime të mëdha dhe të qarta, që padyshim s'janë në favor të burrit të sotëm në shumicën e rasteve.

Pavarësisht nga ajo se ata nuk ishin të

ditur dhe nuk zotëronin diploma universitare në krahasim me burrat e sotëm, shumica e tyre ishin të edukuar dhe me vetëdije të lartë rreth çështjeve fetare dhe atyre jetësore, ndoshta edhe më shumë se sa ata që zotërojnë sot diploma të larta. Deri dje burri ishte ai që e edukonte familjen, e mbronte prej çdo mendimi të huaj jo-islam, që e rrezikon atë personalisht apo familjen e tij. Fjala e tij ishte e respektuar dhe e dëgjuar. Familja e nderonte dhe e respektonte me dëshirë dhe vullnet. Çdo mosmarrëveshje në familje e zgjidhte me mend dhe urtësi. Marrëdhëniet dhe sjelljet brenda familjes dhe jashtë saj qëndronin në dorën e tij, dhe nuk lejonte t'i ndodhte asgjë askujt prej anëtarëve të familjes. Gruas së vet i mbronte pozitën e saj, dhe ishte i kujdesshëm për fëmijët e tij, ku i gëzonin të gjitha të drejtat e tyre familjare dhe personale. Por nëse kthehemi dhe i shikojmë shumicën e burrave të sotëm do të vërejmë çudira. Marrëdhëniet e burrit me gruan në shumicën e shtëpive kanë marrë një pamje trishtuese, plotësisht larg asaj pasqyre që duhet të jenë marrëdhëniet bashkëshortore.

Zakonisht marrëdhëniet bashkëshortore ndahen në tre lloje:



Lloji i parë: Burrë sundues dhe dominues mbi gruan e tij.

Në këtë rast është burri ai që sundon mbi çdo gjë, duke i përbuzur të drejtat dhe ndjenjat e të gjithëve, duke filluar prej gruas së tij. Shpeshherë tenton ta dobësojë personalitetin e saj, t'i anashkalojë të drejtat e saj, fisnikërinë e saj, natyrshmërinë e saj, e pastaj ia ofron për familjen e tij, si një kafshatë e lehtë e nënçmuar. Ka raste të shumta dhe të llojllojshme, ku gratë ankohen nga sjellja e keqe e burrave të tyre. Ja se si na rrëfen njëra prej tyre dhe thotë:

“Jam një zonjë dyzetyjeçare, dhe e martuar prej moshës njëzet e dy vjeç. Kam katër fëmijë, që janë në nivele të larta morali, feje dhe predominimit shkollor dhe atij sportiv. Kam një problem në jetë, e ai është burri im. Problemet mes nesh filluan pasi u martuam, dhe shkaktar kryesor është familja e tij. Ata e nxisin kundër meje, duke shpifur gjëra që nuk i bëj, dhe ai i beson, kurse mua nuk më dëgjon. Tani ka filluar të më bërtasë dhe më qorton haptazi pa asnjë shkak, dhe më nënçmon para vajzave tona, të cilat janë para martesës.”

Na rrëfen një zonjë tjetër dhe thotë:

“Jam një zonjë e martuar që prej shtatë vite e gjysmë dhe kam dy fëmijë. Pavarësisht se i kam kaluar ato vite martesë, tashti dëshiroj të ndahem prej burrit, për shkak të problemeve që m'i shkakton. Faktor kryesor për problemet tona është familja e tij, e nxisin me të madhe kundër meje, e ai i respekton dhe i dëgjon shumë ata, pavarësisht se a kanë të drejtë apo jo. Më nënçmon para tyre dhe ua lejon atyre të më nënçmojnë. Bëj durim sa mundem dhe e rikujtoj veten, se unë veproj me ato vetëm për hir të Allahut. Tani jetoj tek ai vetëm si trup pa shpirt, ia plotësoj të gjitha dëshirat dhe i gëzon të gjitha të drejtat bashkëshortore, por tani e urrej atë shumë, për shkak se jetën ma ka shkatërruar. Tani jam e sëmurë, me depresion të thellë dhe mendoj vetëm për vdekjen”.

“Prandaj, o ti burrë sundues dhe i padrejtë: Gruaja jote është robëreshë e dobët, që babai i saj e ka lënë amanet te ti, dhe Zoti yt do t'i llogarisë sjelljet e këqija dhe të liga ndaj saj...”

Këto shembuj e shumë të tjerë ndodhin si rezultat i personalitetit të dobët të burrit para familjes së tij, dhe mosrespektimit të gruas, duke e përdorur forcën si mjet për sundim. Gabimi i tij në këtë rast vjen si shkak i padijes për administrimin apo menaxhimin e jetës së tij të re, dhe mosveprimi i tij me ekuilibër mes të drejtave familjare, që duhet t'i plotësojë, dhe mes lidhjeve farefisnore, mirësisë ndaj tyre, përfitimin e dashurisë dhe kënaqësisë së tyre, dhe mes të drejtave të gruas së tij morale, materiale dhe mbrojtjen e natyrshmërisë dhe fisnikërisë së saj.

Ky burrë harron se është përgjegjës për gruan e tij para Allahut me përgjegjësi të plotë, dhe harron porosinë e krijesës më të mirë dhe më të drejtë Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili në Haxhin e Lamtumirës, na porosit të kujdesemi për gratë, qofshin vajza, gra të martuara apo nëna: *“O njerëz! Kijeni frikë Allahun dhe silluni mirë me gratë, sepse ju i keni marrë ato amanet nga Allahu dhe me fjalën e Allahut ju është lejuar t'i keni gra”.*

Prandaj, o ti burrë sundues dhe i padrejtë: Gruaja jote është robëreshë e dobët, që babai i saj e ka lënë amanet te ti, dhe Zoti yt do t'i llogarisë sjelljet e këqija dhe të liga ndaj saj. Vepra jote është shumë larg moralit të lartë dhe besimit të kulluar. Na përcjell Ebu Hurejra prej Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, se ka thënë: *“Besimtari me besim më të plotë është ai që ka moralin më të mirë, dhe*

më i miri prej jush është ai që është i sjellshëm me gratë e tij dhe unë jam më i sjellshmi me familjen time”.

Për gruan në këtë rast nuk mbetet gjë tjetër vetëm se të bëjë sabër dhe të kërkojë ndihmë prej Allahut, së pari dhe së fundi. Pastaj, le të kërkojë çdo rrugë, e cila e drejton në përmirësimin e gjendjes së burrit të saj, të sillet mirë me të, të përpiqet të rikujtojë, se Allahu e mbikëqyr çdo sjellje të tij, dhe të bëjë dua vazhdimisht, që Allahu ta udhëzojë dhe ta përmirësojë gjendjen e tij.

Nëse dështon çdo mund i saj dhe burri i saj nuk drejtohet, atëherë le të kapet pas litarit të Allahut dhe të kërkojë pandërprerë ndihmë prej Tij, dhe të rikujtojë se për durimtarët Allahu ka premtuar shpërblime pa llogari. Kjo do t'ia lehtësojë asaj gjendjen dhe dhimbjen në shpirt.

Lloji i dytë: Personalitet i dobët me gruan e tij:

Ky lloj është krejtësisht i kundërt me llojin parë. Në llojin e parë vërejtëm se si burri e flijon gruan për familjen e tij, injorancën dhe epshet e tij, ndërsa në llojin e dytë do të shohim një burrë që e flijon familjen dhe jetën për gruan e tij.

Ky lloj burrave i dhuron gruas jetën e tij, mendjen e tij, i nënshtrohet asaj tërësisht, i respekton urdhëresat e saj dhe i përgjigjet të gjitha dëshirave dhe nevojave të saj. E flijon për atë çdo send, familjen, fisnikërinë, burrërinë, dëshirat e tij, dhe krejt botën që e rrethon. E harron porosinë e Zotit të tij, që t'i respektojë prindërit dhe të sillet mirë me ata. E harron sakrificën e prindërve të tij, që e edukuan, e rritën, e shkolluan, vetëm se për hir të gruas.

Na rrëfen një nënë dhe thotë:

“Jam nënë e një djali, që e rrita me shumë vështirësi. Babai i tij ndërroi jetë herët dhe unë e sëmure përpiquesha t'ia plotësoj të gjitha kushtet. Sot jetoj së bashku me familjen e tij, por më detyron që të jetoj e vetme në dhomë,

të ha vetëm, që mos ta pengoj atë dhe gruan e tij, nuk më lejon të largohem prej shtëpie vetëm se një orë në ditë edhe atëherë duke më shoqëruar shërbëtorja. Jetoj e vetmuar dhe çdo moment pres vdekjen. Më duket se jam e burgosur dhe e kaloj kohën e dënimit në regjim izolimi, ndërsa biri im është ai që më dënoi dhe më burgosi”.

Na rrëfen një baba dhe thotë:

“Jam një plak, i cili i ka kaluar të shtatëdhjetat. Kam tre fëmijë, dhe asnjëri nuk më pranon të jetoj së bashku me familjet e tyre. I propozova që të jetoj në dhomë plotësuese, vetëm që të jem afër atyre dhe të kujdesen për mua, se para pak kohësh fillova ta humb edhe shikimin. Të gjithë e refuzuan kërkesën time dhe më thanë, se do të më vendosin në një shtëpi pleqsh”.

Lloji i tretë: Burrë i drejtë, i mençur, i ekuilibruar:

Ky është lloji, i cili gjendet shumë rrallë sot. Burri i këtij lloji është ai që i frikësohet Allahut, i frikësohet dënimit të Tij, dhe e urren ta takojë Zotin e Tij, duke qenë i padrejtë ndaj të dy palëve. Me urtësinë e tij, me mençurinë e tij dhe me vetëdije të plotë mundohet t'ia plotësojë të drejtat të gjithëve. Mundohet ta kuptojë dhe të respektojë nevojat e çdokujt. I kupton nevojat familjare dhe të drejtat e tyre, i përgjigjet kërkesave të tyre, i dëgjon këshillat e tyre, dhe është i ekuilibruar mes nevojave të tij personale dhe atyre familjare, dhe nevojave të gruas dhe fëmijëve të tij. Gruan e tij e kupton si shok jete, e respekton si krijesë e dashur, e respekton natyrshmërinë e saj, fisnikërinë e saj, dhe në fund nuk i harron detyrat e tij ndaj prindërve dhe familjes së vet.

Prezenca e këtij lloji burrit është shembull i asaj kohe të bukur, kur çdo grua ëndërronte një bashkëshort të tillë dhe një prind për fëmijët e saj. ■

Nga arabishtja: IRFAN JAHIU



HIXHABI I DALLOI BESIMTARET E LIRA PREJ ROBËRESHAVE

“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t’i lëshojnë xhilibabet (mbulojat) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (nga robërshat) e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues.” Ahzab, 59.

SHKRUAN: ALI SHABANI

A demi me Havanë *alejhima selam* kur ishin në Xhenet, mbulesën e trupit e kanë pasur prej nurit (dritës). Pas gabimit të bërë ata ranë në tokë dhe ajo mbulesë u zhduk. Që të dy filluan menjëherë të këpusin gjethe nga bimët aty përreth dhe të mbulojnë sa më tepër pjesë nga trupi i tyre. Edhe pse ata kanë qenë vetëm ata dy dhe ishin bashkëshortë, reagimi i tyre ka qenë në çast dhe si një instinkt i lartë i një qenie njerëzore, që i plotëson cilësitë morale. Hava *alejha selam* si një nënë e ndershme e njerëzimit dërgoi një mesazh historik për vajzat bashkëkohore. Ai mesazh ishte që gratë e ndershme, si shenjë nderi ta mbulojnë trupin e tyre. Me ardhjen e Muhamedit *alejhi salatu ue selam* në këtë Umet si pejgamber i Allahut të Madhëruar u përforcua ky vendim në formën e urdhrit nga Allahu *xhele shanuhu* në Kuranin Famëlartë me ajetin kuranor:

“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t’i lëshojnë xhilbabet (mbulojat) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (nga robërshat) e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues.” Ahzab, 59.

Në këtë ajet kuranor shihet qartë, se Allahu i Madhëruar së pari e urdhëron Pejgamberin *alejhi salatu ue selam* t’i urdhërojë gratë e tij, pastaj bijat e tij e pastaj gratë e besimtarëve të mbulojnë trupin e tyre. Kurtubiu përmend në tefsirin e tij nga **Katade**, se ka thënë: Pejgamberi *alejhi salatu ue selam* pas vdekjes së tij ka lënë nëntë gra, pesë nga fisi Kurejsh: Aisheja, Hafsa, Umu Habibe, Seude dhe Umu Seleme, ndërsa tre nga arabët e tjerë: Mejmune, Zejneb bint

Xhehsh dhe Xhuvejrije, dhe një nga Beni Harun: Safija. Prej bijave të tij Fatimja, Zejnebeja, Rukija dhe Umu Kulthumi, vetëm Fatimja ka jetuar pas Pejgamberit *alejhi salatu ue selam*.

Taberiu në komentin e këtij ajeti thotë, se Allahu i thotë Muhamedit *alejhi salatu ue selam*: O Pejgamber thuaju bashkëshorteve tua dhe vajzave tua, po edhe bashkëshorteve të besimtarëve, të mos u përngajnë robërshave në veshjen e tyre, kur të dalin nga shtëpitë për ndonjë nevojë. Mos t’i zbulojnë flokët dhe fytyrat e tyre, por t’i lëshojnë hixhabet (mbulesat e tyre) deri poshtë, për të mos u shqetësuar nga të shfrenuarit me ndonjë fjalë të keqe. Ka qenë e diskutueshme mënyra e lëshimit të hixhabit. Disa prej tyre kanë thënë se duhet ta mbulojnë fytyrën dhe kokën ashtu që mos të shihet përveçse një sy. Kjo transmetohet nga Ibën Abasi dhe nga Ibën Ubejde. **Ibën Sirini** e ka pyetur Ubejden për ajetin kuranor ***“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t’i lëshojnë xhilbabet (mbulojat) e veta mbi trupin e tyre...”*** e ka mbuluar kokën dhe fytyrën dhe e ka zbuluar një sy. Disa të tjerë kanë thënë se janë urdhëruar ta mbulojnë me hixhabin e tyre ballin. **Taberiu** e përmend nga **Ibën Abasi**, se në lidhje me ajetin kuranor ***“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t’i lëshojnë xhilbabet (mbulojat) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (nga robërshat) e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues”*** thotë: Gratë e lira më parë vishnin rroba si robërshat dhe Allahu i Madhëruar i ka urdhëruar gratë e besimtarëve t’i lëshojnë mbulesat. Lëshimi i mbulesave të bëhet, duke e mbuluar trupin dhe kokën me ballin. Nga **Katade** përcillet se në lidhje

me këtë ajet ka thënë: se kur ka kaluar robëresha nëpër rrugë, e kanë ngacmuar, kështu që Allahu i ndaloi gratë e lira t'u përngjajnë robëreshave. Njësoj e ka komentuar **Muxhahidi**, i cili thotë: e mbulojnë trupin me xhilibab (hixhab), që të njihen se janë të lira dhe mos t'u dalë përpara ndonjë i shfrenuar e t'i pengojë me ngacmime, apo fjalë shqetësuese.

Ebu Salihu tregon: Kur ka ardhur Pejgamberi *alejhi salatu ue selam* në Medinë, gratë gjatë natës dilnin për të kryer nevojën. Ka pasur meshkuj, që kanë ndenjur në rrugë dhe i ngacmonin gratë. Për këtë Allahu e zbriti këtë Ajet.

Ibn Kethiri në tefsirin e tij, në lidhje me këtë ajet thotë: Allahu e ka urdhëruar të Dërguarin e tij, që t'i urdhërojë gratë besimtare e në veçanti gratë dhe vajzat e tij për nderin që kanë t'i lëshojnë hixhabet e tyre më gjatë për t'u dalluar nga pamja e grave të kohës së xhahilijetit dhe nga robëreshat.

Ikreme ka thënë duke komentuar këtë ajet: t'i mbulojnë gjokset e tyre.

Umu Seleme ka thënë: pasi ka zbritur ajeti **“le t'i lëshojnë xhilibabet (mbulojat) e veta mbi trupin e tyre”** gratë e ensarëve kur kanë dalë, kanë ecur sikur të kishin mbi kokat e tyre korba të zinj nga kujdesi dhe kishin veshje të zeza.

Kurtubiu e përmend në tefsirin e tij, se arabët e kanë pasur zakon të zbukurohen dhe i kanë zbuluar fytyrat e tyre, ashtu siç bënin robëreshat, dhe kjo ka shkaktuar, që burrat të shikojnë tek ato. Për këtë Allahu ka zbritur ajetin kuranor: **“O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t'i lëshojnë xhilibabet (mbulojat) e veta mbi trupin e tyre...”**, kështu që e urdhëroi Pejgamberin t'ua kumton urdhrin të mbulohen gratë, kur ato kanë nevojë për të dalë nga shtëpia. Gratë dilnin për nevojë në shkretëtirë, se

“Umu Seleme ka thënë: pasi ka zbritur ajeti “le t'i lëshojnë xhilibabet (mbulojat) e veta mbi trupin e tyre” gratë e ensarëve kur kanë dalë, kanë ecur sikur të kishin mbi kokat e tyre korba të zinj nga kujdesi dhe kishin veshje të zeza...”

në fillim nuk kanë pasur nevojtoje. Urdhri ka ardhur që ato kur të dalin, të jenë të mbuluara për t'u dalluar nga robëreshat dhe t'i dallojnë burrat e mos të sillen me to si me robëreshat. Ka ndodhur në disa raste kur kanë dalë gratë për të kryer nevojat e tyre, burrat duke mos i dalluar ato prej robëreshave janë sjellë me to, si me robëreshat. Pastaj gratë janë ankuar tek i Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* dhe ka zbritur ky ajet si shkak i kësaj.

Mbulesa e grave që është përmendur në ajet në gjuhën arabe “xhelabib” është shumësi i “xhilibab”. Xhilibabi është veshje e grave që e mbulon të tërë trupin.

Arabët e kanë pasur edhe më parë këtë veshje, por e kanë mbajtur të hapur, apo nuk i kanë mbuluar flokët, apo e kanë mbajtur prej në gjysmën e kokës të lëshuar poshtë, duke e lënë gjoksin të hapur. Kur ka ardhur urdhri është dashur vetëm një përmirësim, apo plotësim në mbulimin e trupit të tyre.

Mbulesa duhet ta mbulojë trupin dhe mos të jetë e tejdukshme. Na përcillet se Dihje el-Kelbi, kur është kthyer nga Herakliu, i cili i kishte dhënë një copë pëlhere, Pejgamberi *alejhi salatu ue selam*

i tha merre gjysmën ti, ndërsa gjysmën tjetër jepja gruas tënde të mbulohet dhe le të vendosë diçka edhe nga brenda, që mos të duket. Po ashtu Pejgamberi *alejhi salatu ue selam*, në lidhje me veshjen e hollë e të tejdukshme ka thënë: “*Ndoshta ajo që vishet me rroba të tejdukshme do të jetë e zhveshur në Ahiret.*” Kur ia kanë përmendur Ebu Hurejres veshjen e hollë të grave ka thënë: Ato gra që vishen me rroba të tejdukshme (apo të ngushta që e përshkruajnë trupin), janë të zhveshura. Një ditë kanë hyrë tek Aisheja disa gra nga Beni Temim me veshje të hollë (të tejdukshme) dhe ajo u ka thënë: “Nëse jeni besimtare, atëherë kjo nuk është ajo që veshin besimtares, a nëse nuk jeni besimtare, atëherë vazhdoni me veshjen që keni.” Gjithashtu mbulesa e gruas nuk duhet të ketë ngjyrë tërheqëse, që të tërheqë shikimet e burrave. Një ditë kur hyri tek Aisheja një nuse me mbulesë të ngjyrosur (e verdhë e theksuar). Aisheja i tha: “Nuk ka besuar në suren Nur ajo që vesh këtë.”

Imam Kurtubiu përmend se pjesa e ajetit “*pse kjo është më afër që ato të njihen*”, d.m.th. të dallohen nga robëreshat, por megjithatë më vonë nga dijetarët kanë thënë, se tani ky urdhër duhet t’i përfshijë gratë e lira dhe robëreshat së bashku. Siç ka ndodhur kur Pejgamberi *alejhi salatu ue selam* ka porositur që burrat mos t’i ndalojnë gratë të prezantojnë në xhami. Mirëpo pastaj sahabët në rrethana të tjera i kanë ndaluar dhe Aisheja ka thënë: “Po të ishte gjallë Pejgamberi *alejhi salatu ue selam* do t’i ndalonte.”

Allahu i Gjithëmëshirshëm e përfundon ajetin me fjalët: “*Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues*”. Mufesirët e Kuranit thonë se “*Allahu fal gabimet e kaluara,*” që më parë nuk ishin mbuluar

“Ndoshta ajo që vishet me rroba të tejdukshme do të jetë e zhveshur në Ahiret...”

ashtu si duhet dhe “*Ai është mëshirues*” për në të ardhmen nëse ato pendohen dhe pastaj mbulohen.

Shtojcë: Në fenë e krishtere mbulimi i kokës është urdhër. Në Bibël shkruhet, se gruaja e ndershme nuk bën të dalë në vende publike me kokë të zbuluar. Mirëpo këtë praktikë e zbatojnë gra të caktuara fetare dhe i quajnë “*motra të nderit*”, për shkak se i kanë të mbuluar kokat e tyre. Po gratë tjera që nuk i kanë mbuluar kokat si t’i quajmë?

Feja islame i thërret të gjitha gratë muslimanë të jenë nën hijen e nderit. Le të bëjmë këto krahasime:

Si duket fletorja, apo libri pa kopertinë? Si duket shtëpia kur ia heqin kulmin?

Ne e dimë se ka shumë gra të ndershme, por rrethanat kanë qenë shkak që ajo mos të ketë anën tjetër plotësuese të nderit, hixhabin. Megjithatë... E lusim Allahun e Gjithëmëshirshëm ta mbrojë nderin e grave të besimtarëve dhe t’i vetëdijesojë që ta kuptojnë urdhrin e Allahut të Madhëruar, Zotit të tyre Mëshirëplotë. ■

LUTE ALLAHUN TË MOS ZBULOHEM



Ata ibën Ebu Rebahu thotë se isha me Abdullah ibën Abasin, i cili më tha:

“A ta tregoj një grua e cila është prej banorëve të xhenetit? E unë i thashë: Po. Ai më tha se ajo gruaja e zezë (zezake) që erdhi te Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem, dhe i tha: “Unë sëmurem (nga epilepsia) dhe më zbulohen aurretet e mia, prandaj lute Allahun që të më shërojë”, kurse Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem, ia ktheu: “Nëse do të bësh sabër ndaj kësaj sëmundje të garantohet xheneti, por nëse dëshiron unë lutem për ty e do të shërohesh.” Atëherë kjo grua zgjodhi që të bëjë sabër, por kërkoi të lutej, që të mos zbulohet avreti i saj në momentet e sëmundjes e kështu Profeti, sal-lallahu alejhi ue selem, u lut që mos të bulohet pas asaj dite”.

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Këtë hadith e shënon imam Buhariu në Sahihun e tij, nr. 5652, si dhe imam Muslimi, nr. 2576.

Disa hollësi rreth këtij tregimi:

Para se të flasim rreth komentit të hadithit dua të përmend disa njohuri të

përgjithshme rreth këtij tregimi, të cilat mendoj se nëse dihen është në dobi të lexuesit dhe ai përfiton prej tyre.

-Emri i kësaj gruaje përmendet se ishte Suajreh, por disa të tjerë thonë se ajo quhej Umu Zufer, ndërsa mendoj se ka mundësi që ajo të quhej Suajreh, kurse nofka e saj mund të ketë qenë Umu Zufer, edhe pse këtë që po përmend nuk e

“Çfarë ndiejnë shumë femra të ditëve të sotme, të cilat pa pikë turpi, pa pikë arsyeje zbulohen, të cilat janë plot vetëdije, të mençura dhe askush nuk i detyron...”

të shpejtë tek Qabeja dhe kapej pas mbulojës së saj, duke e lutur Allahun që t’ia largonte atë. Këto janë disa nga njoftimet që na jepen rreth kësaj gruaje nëpër transmetime të ndryshme.

Komenti i hadithit:

Fjala: “A ta tregoj një grua e cila është prej banorëve të xhenetit? E unë i thashë: Po”

Kjo pjesë tregon rëndësinë e sahabëve dhe brezave të parë, për interesin e madh që tregonin për xhenetin dhe arritjen tek ai. Në këtë fjalë Ibën Abasi dëshiron t’i tregojë diçka nga dituria e vet, nxënësit të tij Atait dhe njëherazi t’ia rrisë ambiciet për punë, duke i treguar për një grua, e cila ecte mbi fytyrë të tokës, jetonte me ta, ndoshta mund të mos çmohej nga të tjerët, por në fakt ajo ishte njëra nga banoret e xhenetit, së cilës i ishte garantuar nga Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ky pra, është qëllimi pse Ibën Abasi e thirri nxënësin e tij ta shikonte atë grua, ku mendoj se duhet pasur kujdes, që askush të mos mendojë se ata të dy po shikonin gratë e të tjerëve nëpër rrugët e Mekës, ngase kjo nuk qëndron për shkaqet që i përmenda, si dhe për faktin se ajo tashmë ishte në moshë, ishte zezake dhe mbi të gjitha ishte e mbuluar e nuk kishin çfarë të

mbështes në ndonjë argument apo fjalë të dijetarëve. Allahu e di më së miri!

-Dijetarët përmendin se kjo grua ishte ajo që ia krihte flokët Hatixhes, *radijallahu anha*, bashkëshortes së Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe e vizitonte shpesh atë.

-Ibën Haxheri përmend se nga transmetimet e shumta kuptohet, se gruaja në fjalë sëmurej nga xhinët dhe nuk kishte ndonjë sëmundje tjetër, qoftë fizike apo psikike.

-Ajo jetonte në Mekë dhe sa herë që ndiente sikur po i afrohej shejtani për ta kapluar me këtë lloj sëmundje shkonte me

shihnin nga trupi i saj edhe po të donin.

Fjala: “Nëse do të bësh sabër ndaj kësaj sëmundje të garantohet... por kërkoi të lutej që të mos i zbulohet avreti i saj në momentet e...”

Nga hadithi në vazhdim vërehet se kjo grua ishte e sëmurë dhe nga sëmundja i humbte vetëdija aq shumë, sa ndodhte që ta zbulonte edhe trupin e saj. Ajo kërkoi nga Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të lutej e ai i dha një mundësi zgjedhjeje, duke i thënë që ta duronte sëmundjen e kështu t'i garantohet xheneti dhe gruaja pranoi. Pranoi por edhe pse Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk ceki asgjë fare rreth zbulimit të trupit të saj gjatë këtyre çasteve, që do të thotë se nga biseda nuk kuptohet, se fitimi i xhenetit kushtëzohej me mos-zbulimin e trupit, pra thjesht aty nuk u cek asgjë rreth mbulesës, megjithatë kjo grua ia rikujtoi Profetit zbulimin e trupit, duke kërkuar që të lutej për të mos ndodhur prapë diçka e tillë.

Ky rrëfim madhështor na tregon interesimin e grave të sahabëve, gjeneratës së Profetit, të cilat e kishin kuptuar shumë mirë çështjen e mbulesës. Ato e kishin kuptuar, se ajo është detyrim hyjnor me të cilin nuk duhet të luajë askush. Këtë gjë e dinte mjaft qartë edhe kjo grua zezake, e cila nga transmetimet nuk kuptohet aspak, nëse ishte shumë e ditur apo merrte pjesë në ligjëratat e Profetit. Megjithatë këto gjëra i dinte mjaft mirë, sepse ishin të njohura për këdo. Askush nga ato nuk e konsideronte zakon vendor apo traditë të fiseve dhe të qyteteve, por e dinin shumë mirë se ishte detyrim hyjnor. Jo si në kohët tona që dikush edhe pse çirret duke bërëtitur se është njeri i ditur, bile edhe udhëheqës i të

diturve, por fatkeqësisht është koka e injorantëve, sepse nuk e ka kuptuar që mbulesa është detyrim nga Allahu e jo një tekë personale sipas dëshirës, bile ka harruar se edhe nëna e tij ishte e mbuluar dhe ashtu me mbulesë e ka rritur, e ka ushqyer dhe e ka shkolluar. Pra, këta njerëz sa shpejt e harruan, se jo vetëm që mbulesa është detyrim hyjnor, por edhe traditë e vendit e trashëguar brez pas brezi. Por këtyre të “shkolluarve” iu është rritur mendja, sepse kanë hipur në pozita dhe mendojnë se e kanë kaluar edhe Urën e Siratit, e nuk ka më keq në botë se sa mendjemadhësia, bile populli kur dëshiron dikë ta mallkojë i thotë: “HAJT E TU RRITËT MENDJA” e kujt i rritet mendja të gjithë e dimë se si i vjen fundi.

-Tek këto gra të nderhme mbulesa ishte gjë e kryer rreth së cilës nuk diskutonin e as që e përmendnin, prandaj edhe ajo kërkoi me aq ngulm që të mos i zbulohet trupi. Ajo e kërkoi këtë edhe atëherë kur i erdhi lajmi për fitimin e Xhenetit, e megjithatë ajo nuk u habit, por u preokupua me këtë çështje. Kurse disa gra të sotme po t'u jepet një mundësi, një post apo detyrë sado e vogël qoftë ajo, nga e cila ato do të përfitonin ekonomikisht, shumë prej tyre nuk e kanë dert punën e trupit apo të nderit të vet. Zoti na ruajt nga gjëra e tilla!

-Ibën Haxheri gjatë komentit të këtij tregimi thotë se në disa transmetime përmendet, se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i tha se nëse do të bënte durim me këtë sëmundje, atëherë nuk do të llogaritej për veprat e saj. Pra, nuk do të llogaritej çfarë mund të bënte në ato çaste, gjithashtu nuk do të llogaritet për mëkatet e saj në botën tjetër. Megjithatë

përkundër mos-llogarisë ajo prapë kërkoi të lutej që të mos i zbulohet trupi, pra nga kjo lutje kuptohet qartë se ajo e ndiente në vetvete, që mbulimi i trupit ishte diçka që duhej pasur kujdes, edhe atëherë kur nuk llogaritej për të njeriu, ishte turp i ngulitur thellë në vetëdijen e çdo femre. Ashtu ishin ato gra, të cilat edhe pse u garantohej xheneti nga gjuha e atij, i cili nuk fliste me hamendje ato prapë mërzhiteshin dhe kujdeseshin për trupin e vet. Lind pyetja: çfarë ndiejnë shumë femra të ditëve të sotme, të cilat pa pikë turpi, pa pikë arsyeje zbulohen, të cilat janë plot vetëdije, të mençura dhe askush nuk i detyron, nuk iu ka humbur vetëdija, siç ndodhte me këtë grua zezake, por prapë zbulohen. Asnjëri prej tyre nuk i është garantuar xheneti e as nuk i ka thënë kush, se kjo lakuriqësi nuk do t'ju llogaritet si mëkat. Por me gjithë pretendimet e tyre, se janë gra të mençura arrijmë të kuptojmë nga gjendja e tyre, se ato janë gjithmonë të sëmura nga djajtë, përderisa gjithmonë janë të pakujdesshme ndaj trupit të tyre. Zoti i udhëzoftë!

-Kur u kërkua nga Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të lutej për të që të mos zbulohet ai u lut dhe me të vërtetë Allahu ia pranoi lutjen atij, sepse Zoti i pranon lutjet e të dërguarve të Tij. Një rast i tillë është ideal për të argumentuar faktin, se udhëheqësit shpirtërorë e sidomos ata shtetërorë duhet të kujdesen sa më shumë për mbulesën e femrave muslimane. Sa duhet të interesohen që femrat të mbulohen, po aq duhet të bëjnë çmos për t'i mbuluar ato. Fillimisht këtu kam si qëllim vetë muslimanët me në krye hoxhallarët, të cilët duhet të interesohen për këtë çështje, ta luftojnë zhveshjen me

çdo mundësi dhe çdo kapital, duke filluar nga anëtarët e familjeve të veta e pastaj edhe më gjerë. Por ka raste, për fat të keq që dëgjojmë dhe shohim prej tyre që me fjalë është i pari, por me punë i fundit, shohim se kanë vërejte tek të afërmit e vet, të cilët i ka nën përkujdesje. Zoti na udhëzoftë në përmbushjen e këtij detyrimi, ngase sot janë të shumtë ata që flasin me gojë, por të pakët ata që flasin me punë. Kjo nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, pra nga udhëheqësit shtetërorë është detyrim edhe më i madh, që të vendosin ligje, që e detyrojnë mbulesën e kështu ta plotësojnë një urdhër të Allahut e jo të vendosin ligje që ua ndalon një detyrim të tillë. Kushdo që vepron gjëra të tilla, që janë në kundërshtim me ligjin e Allahut le ta dijë, se nuk e ka punën mirë me Allahun dhe në mos sot apo nesër, por patjetër një ditë do të bëhet pishman me ligjet e tij, sepse nuk ka dalë njeri ta kundërshtojë ligjin e Allahut veçanërisht mbulesën, e Allahu të mos e ketë bërë shembull të keq nga i cili marrin mësim të mençurit e kësaj bote para botës tjetër. Asnjëri prej tyre nuk duhet të harrojë, se pozitën që ia ka dhënë sot Zoti, ajo nëse keqpërdoret nuk është asgjë tjetër për të veçse shtim i hidhërimit dhe dënimit të Allahut për të në këtë botë dhe në tjetrën. Në fund u drejtohem të gjithë këtyre njerëzve të kthehen tek Allahu me pendim para se të jetë bërë vonë. ■



PSIKOLOGJIA E NJERËZVE TË RËNDOMTË

Dallimi i vetëm në mes trimave dhe qyqarëve është se të parët dinë të fshehin, ose të kontrollojnë frikën e tyre, e cila iu paraqitet si shprehje e vetëdijes për rrezikun e afërt. Qendrat e fuqishme të ndryshme, në çdo vend dhe kohë, kanë mekanizma për injektimin e frikës në masat e gjera dhe individët, ngase frika e injektuar është sedativi më i mirë për kontrollin e njeriut tjetër

SHKRUAN: PRIM. DR. MED. SC. ALI ILJAZI

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëmadh urdhëron e thotë: *“Allahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues.”* (Nahël, 78).

Në agimin e jetës së tyre njerëzit e vegjël fantazojnë rregullisht që të bëhen heronj që do ta shpëtojnë botën, trima që do të

mbizotërojnë fantazmat, kalorës që do t'i kundërvihen me burrëri të këqijve, ose gjeni që do të përparojnë në jetën kolektive.

Dhëmbi i kohës ngadalë bren ëndrrat fëmijërore, dhe njeriu zgjohej në kohën dhe hapësirën ku është i kënaqur me atë që ka bashkëshorten me të cilën do të pijë kafënë pas punës së rëndë që ka bërë për pak të holla, fëmijën i cili përpin materialin arsimor konvencional dhe maces së cilës mundohet t'i hedhë disa thermi ushqimi.

Hapësira në të cilën fëmija zhvillon egon e

tij është e mbuluar me pllaka të mundësive të pashteruara të imagjinatës ngjitëse, e cila operon në bazë të shembujve të personave trima nga filmat vizatimorë, në të cilët është lehtë të zhytet. Më vonë, fantazinë fëmijërore fillojnë ta ngulfatin kornizat e programeve shkollore të shabllonizuara, roli i të cilëve është kualifikimi i vërtetë i këtyre njerëzve të rinj. Shpesh kualifikimi i resurseve njerëzore zhvillohet nëpërmjet pyetësorëve të papërgjegjshëm me anë të cilëve 'ndihmohen' filloristët dhe nxënësit e shkollave të mesme në zgjedhjen e orientimit të tyre profesional, dhe në bazë të rezultateve të këtyre pyetësorëve u sugjerohen të gjithë klasës që të gjithë kanë p.sh. afinitet muzikor më të shprehur, dhe në këtë drejtim duhet të perfeksionohen. Këso pyetësorësh joprofesionalë janë larg nga subtiliteti, i cili mund të njohë gjurmë matematikore, letrare, në fitues të rinj potencialë të çmimeve Pulitzer, Nobel etj.

Ngulfatja e zhvillimit unikal dhe e potencialit individual mund të dëgjohet edhe nga minberi kur lideri fetar me dëshirë që të demonstrojë kuptimin personal funksional në një shoqëri dinamike në realitet demotivon zhvillimin akademik të shoqërisë së tij me fjalët:

"Nuk mund të jeni të gjithë me fakultet! Dikush duhet të jetë bukëpjekës, këpucëtar, automekanik etj".

Në mënyrë të drejtë pedagogjike duhet të thuhet:

"Ju të gjithë keni kapacitet në veten tuaj të bëheni magjistra dhe doktor shkencash pa marrë parasysh shkallën e arsimimit që keni tani! Sepse magjistratura dhe doktoratura nuk janë asgjë tjetër përveç një numri të caktuar librash të lexuar dhe një numër i caktuar provimesh. E ju të gjitha këto mundeni t'i bëni!"

Fara e mbjellë një herë, po vazhdojnë të ushqehen me metoda pedagogjike të gabuara

“Pyetja me të cilën më vonë takohet çdo person i vetëdijshëm është: si t'i ngadhënjejë frikësimet e jetës, apo si t'i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme frikave moderne ...”

të subjekteve të ndryshëm të një mjedisi të caktuar klaustrofobik, e që në fund bëhen të njohur në formën e letargjisë së shenjtë të hutuar dhe kultit të personave të dobët. Kurani thekson në shembullin e njerëzve të zgjedhur të gjithë esencën e afrimit të alternativës nga shkaqe të qarta pedagogjike:

“...Ai (Ibrahimi) tha: O djali im, unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të pres ty. Shiko pra, çka mendon ti?” (Es Saffat, 102).

Verseti i cituar është paradigma me të cilën ndërtohet i tërë koncepti edukues, i cili nënkupton përfshirjen e hershme të fëmijëve në procesin e vendosjes dhe vërehet në pyetjen e thjeshtë (p.sh. Çka mendon ti? Si e sheh këtë ti? Si do ta bëje këtë ti? etj), ku tregohet vlerësimi i mendjes së fëmijës dhe nxitja me kohë e procesit të mendimit (p.sh. Më pëlqen ky mendim! Jam i mahnitur me këtë vështrim! Këtë ide më duhet ta shënoj! etj). Efekti i këtillë i qasjes ka për fëmijët në kuptim të nevojës së tyre të jenë në lartësinë e detyrës, është më shumë se fascinues. Të gjithë njerëzit dikur do të ballafaqohen me ndjenjën e esencës individuale. Zakonisht kjo është në kohën e pubertetit, kur djaloshi apo vajza fillojnë të kërkojnë seriozisht vendin e tyre në kohën në të cilën jetojnë.

Pyetja me të cilën më vonë takohet çdo person i vetëdijshëm është: si t'i ngadhënjejë frikësimet e jetës, apo si t'i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme frikave moderne ekzistenciale, tek të cilat janë bazat kryesore

në të cilat mbështeten grabitësit e ndryshëm të potencialit njerëzor?

Personi i bindur në dritën gjithëpërfshirëse të Islamit “La ilahe il-lallah” (nuk ka të adhurar me meritë pos Allahut) është fjala më e fuqishme e universit dhe që kuptimi i thellë i saj mund të ndërtojë botën në mënyrë të harmonizuar dhe të mbrojë individin nga kurthet e frikave, të cilat sistemet eksperimentale shoqërore-politike i hedhin në mendjet e individëve dhe të tërë shoqërisë. Njeriu modern është i ngarkuar me autoritete të shumtë të gabuar të formuar nga mediet e ndryshme dhe të cilët shkaktojnë frikë të pakëndshme dhe paralizuese.

Funksionaliteti i maksimës islame, duke marrë parasysh kontekstin e mëparshëm, vërehet në sa vijon:

Maksima themelore e islamit “La ilahe il-lallah”

a) “la ilahe (nuk ka të adhurar me meritë) d.m.th. mohim i të gjithë autoriteteve të rrejshëm dhe;

b) “il-lallah” (përveç Allahut) d.m.th. pohim që ekziston vetëm një autoritet suprem fjalët e të cilit janë parametër për vendosjen e të gjitha marrëdhënieve në mes genieve dhe kozmosit;

Allahu i Madhërishëm dëshiron që njeriu të jetojë një jetë të qëndrueshme psikofizike, dhe për këtë thekson pranimin e vetëm një frike - e kjo është frika ndaj Allahut, gjegjësisht vetëdija konstante për mbikëqyrjen e Allahut. Kjo vetëdije për Zotin apo frika nga Ai, shkon absolut në favor të njeriut, sepse kjo është mënyra më e mirë dhe e vetme, që të eliminojë qendrat e ndryshme të fuqishme, të cilat manipulojnë me masat, ndonjëherë duke shkaktuar pasivitete dhe marginalizim, e ndonjëherë mobilizim. Duke pranuar Allahun e Plotfuqishëm si autoritet suprem, QENIE e cila nuk ka lindur dhe as nuk lind, duke ia përcaktuar të gjitha kontaktet shoqërore dëshirës së Tij - ne në realitet i

japim vlerë më të lartë të gjitha veprave tona, sepse arsimohemi në emër të një qëllimi më të lartë të përkufizuar me qëllimet e sheriatit, e jo p.sh. në emër të jetës luksoze etj.

Duke iu frikësuar Allahut të Madhërishëm ne nuk do të ndalemi duke u bërë mirësi njerëzve të tjerë, edhe në qoftë se ata nuk na falënderojnë për këtë, sepse veprat tona kanë si qëllim kënaqësinë e Tij, e jo pragmatizëm apo kënaqësinë e vogël ndaj egos së madhe.

Maksima “La ilahe il-lah” e kuptuar thellësisht është mënyra më e mirë, që të nxitet njerëzimi në veprime konstante pozitive dhe dalje nga pasiviteti, eliminon frikën nga mos-njohja shoqërore, frika nga kritika njerëzore, frika nga mos suksesi, frika nga armiqtë e krijuar artificialisht, frika nga plakja ose frika nga vdekja e tij.

Mirëpo, e tërë kjo është kaq e thjeshtë? Do të shohim në vazhdim.

FRIKA, BALLAFAQIMI DHE KONTROLLA

Njëra prej skenave më simpatike në tërë Kuranin Fisnik është e përshkruar në versetin vijues:

“E ti hidhe shkopin tënd! E kur e pa atë që lëvizte si të ishte gjarpër, ai (nga frika) u kthye prapa duke mos pasur më kujdes...” (Neml, 10).

Paramendoni Musain *alejhi selam* njërin prej pesë pejgamberëve më të mëdhenj të Allahut pejgamberin, i cili iu kundërvu tiranit më të madh, faraonit, njeriu tejet i fuqishëm që me një goditje e mbyti kundërshtarin, por tani ikën si pa kokë nga frika e një shkopi të rëndomtë. Zoti i tij e thërret, duke ia larguar frikën, i sjell qetësi dhe ia thekson statusin e tij:

“...O Musa! Mos u frikëso, se pranë meje të dërguarit nuk frikësohen!” (Neml, 10)

Ky shembull, ilustron bukur mentalitetin e një njeriu që Allahu i Madhërishëm e ka zgjedhur dhe e ka përgatitur për detyrë të madhe. Shpesh në fe merret racionaliteti i shëndoshë dhe kjo me shpjegime

institucionale të gabuara vërehet në rregulla klerikale me amputim të dimensionit shoqëroro-politik. P.sh. namazi në xhemat është më i vlefshëm se ai individual për 27 herë, sepse mundëson socializimin, shkëmbimin e mendimeve dhe përparimin e aftësive organizative personale në kuptimin e gjerë të fjalës. Nëse dobia njëzet e shtatë herësh nuk kuptohet në këtë kontekst dimensionin e tij shoqëroro-politik do të jetë i humbur. Haxhiu i cili vjen nga haxhi kryesisht me parfume, tespihe, sexhade, ujë zemzemi në vend të adresave të kontaktit me myslimanët e tërë botës, ka lënë gjithashtu dimensionin shoqëroro-politik të haxhit, duke treguar, në mes të tjerash edhe udhëtimin e pakulturuar etj. Duke e përgatitur Musain *alejhi selam* për ballafaqimin me elitën e kohës së tij –pra, magjistarët - Allahu i Lartësuar e pajisi këtë njeri me argumente të nevojshme duke e njoftuar më parë me natyrën e sjelljes dhe funksionimit të tyre.

Musai *alejhi selam* me takimin e tij të parë me argumentin e dhënë, gjegjësisht me shkopin, i cili kthehet në gjarpër i rrezikshëm dhe i shpejtë reagon sipas perceptimit personal, dhe në momentin e caktuar zgjidhja ishte të ikë me vrap. Allahu i Madhërishëm nuk e qorton për shkak të ikjes, por zhvillon vetëdijen e tij për sigurinë personale në praninë e Allahut të Madhërishëm, duke e thirrur me emrin personal, por edhe në imperativ **‘Mos u frikëso’**, i cili është pjesë përbërëse e çdo qasje të shëndoshë psikologjike - pedagogjike. Pas bindjes se ky gjarpër i është nënshtruar frika e tij zbehet, por nuk zhduket, dhe e vërejmë në situatën tjetër edhe më tej të frikësuar, por me një ndryshim, se tani u mësua të kontrollohet:

“Ata thanë: “O Musa, do të hedhësh ti apo ne po hedhim të parët?” Ai (Musai) tha: Jo, hidhni ju! Kur, ja, atij iu duk se nga ajo magji e tyre litarët dhe shkopinjtë lëviznin (si

“...Allahu i Madhërishëm dëshiron që njeriu të jetojë një jetë të qëndrueshme psikofizike, dhe për këtë thekson pranimin e vetëm një frike - e kjo është frika ndaj Allahut...”

gjarpërinj). *E Musai ndjeu në vetvete një farë frike. Ne i thamë atij: ‘Mos ki frikë, është e sigurt se ti do të jesh triumfues!’* (Ta Ha, 65-68).

Dallimi i vetëm në mes trimave dhe qyqarëve është se të parët dinë të fshehin, ose të kontrollojnë frikën e tyre, e cila iu paraqitet si shprehje e vetëdijes për rrezikun e afërt. Qendrat e fuqishme të ndryshme, në çdo vend dhe kohë, kanë mekanizma për injektimin e frikës në masat e gjera dhe individët, ngase frika e injektuar është sedativi më i mirë për kontrollin e njeriut tjetër. Në kohën e Musait *alejhi selam* këto kanë qenë p.sh. magjitë e frikshme para së cilave masa rrëqethej dhe iu përulëshin magjistarëve ekspertë, të cilët krijonin sistemin e besimit në funksion të robërimit mental të masave.

Sot në mënyrë kreative këtë frikë ekzistencionale e realizojnë garat e pakursyera kapitalistike, ose frika kreative nëpërmjet torturave dhe përulën e gjithë bota e tanishme. Zoti i Madhërishëm, ashtu siç e pamë edhe në skenën e cituar shfrytëzon rastin të mënjanojë frikën e tepërt nga zemra e Musait *alejhi selam* duke përsëritur **‘Mos u frikëso!’** Pos kësaj, shohim Musain *alejhi selam* në cilësinë e taktikut të qartë, i cili edhe pse i furnizuar me armë dhe i aftësuar me mjeshtëritë e nevojshme, nuk vrapon para rrezikut, por duke mbajtur për vete potezin përfundimtar, me urtësi ndërton përparësinë

në paraqitje:

"Ai (Musai) *tha: Jo, hidhni jul...*" (Ta Ha, 66)

Inteligjencën sociale të Musait *alejhi selam* si dhe dimensionin e ri të personalitetit të tij mund ta shohim nëpërmjet kuptimit të shkëlqyer të mentalitetit të diktatorit dhe zullumqarit, dhe marrja në konsideratë që më parë e aspekteve të ndryshëm të mundshëm të reaksionit negativ në veprimin e tij:

"(Përkujto) *Kur Zoti yt e thirri Musain: Të shkosh tek ai populli zullumqar!*" Populli i faraonit, a nuk janë duke u frikësuar (dënimit)? Ai (Musai) *tha: Zoti im, kam frikë se do të më trajtojnë si gënjeshtar. Do të më shtrëngohet kraharori* (shpirti) *im dhe nuk do të më lëshohet gjuha ime* (të flas rrjedhshëm), *prandaj dërgoje* (bëje peygamber) **Harunin." (Shuaraë, 10-13).**

Në këtë rast Allahu i Madhërishëm e thekson te ky njeri i zgjedhur frikën nga mos-suksesi, si shprehje e kuptimit të thellë të detyrës gjithëkomplekse, si dhe të kuptuarit e mangësive personale me propozimin konkret për ndihmësin, i cili do ta ndihmojë në misionin e tij. Musai *alejhi selam* demonstroi njohjen e shkëlqyer të vetes së tij, duke pikturuar qartë mënyrën e reagimit të organizimit të tij në situata të caktuara.

"Do të më shtrëngohet kraharori (shpirti) ***im dhe nuk do të më lëshohet gjuha ime*** (të flasë rrjedhshëm)..."

Mirëpo, jo vetëm kaq. Musai *alejhi selam* thekson edhe kuptimin e diapazonit të tij dhe tregon ndjenjën e shprehjes për punë ekipore, duke kuptuar që detyra e tij e tejkalon kapacitetin individual pa marrë parasysh sa i madh ka qenë ai. Këtu është interesant të vëremë nivelin e lartë të individualitetit, që shpreh Musai *alejhi selam* dhe kjo në komunikim direkt me Zotin e botëve! Musai *alejhi selam* nuk ngurron që të flasë hapur për atë që mendon si pika të dobëta të misionit, i cili i ofrohet, duke thënë: **"...prandaj dërgoje** (bëje peygamber)

Harunin"

Nga ky individualitet tejet i shprehur i Musait *alejhi selam* ka pasur dobi direkt edhe vetë peygamberi ynë Muhamedi *alejhi salatu ue selam* dhe ummeti i tij, kur Musai *alejhi selam* në miraxh e këshilloi të kërkojë nga Zoti i botëve (disa) herë zvogëlimin e numrit të namazeve të detyruara gjatë ditës, përderisa Muhamedi nuk u turpërua të kërkojë më pak se pesë kohët e detyruara të namazit ditor.

PËRFUNDIM

Diapazoni i gjerë i të gjithë njerëzve të mëdhenj, që i përmend Kurani kanë qenë njerëz të rëndomtë të lindur pa dituri dhe pa përvojë, me nevojat që përcjellin çdo njeri mesatar të sprovuar me gra, sëmundje, uri, me fëmijë të padëgjueshëm, me gabime nga e kaluara, me dobësi momentale etj. Por me këmbë fuqishëm në tokë, të edukuar me drejtësi, tejet realë dhe racionalë, të gjithanshëm, të kalitur nëpër sprova të ndryshme dhe me intuitë të stërholluar për të njohur shansin për pushtimin e zemrave dhe shfrytëzimit të momentit të duhur të veprimit.

Ndoshta viza më e fuqishme e karakterit të tyre ka qenë gatishmëria që të ballafaqohen me nxitjet pa marrë parasysh frikën, e cila i ka përcjellë, por kanë vepruar me konsekuencë duke arritur një nivel të lakmueshëm të vetëaktualizimit, duke rrënuar në këtë mënyrë logjikën themelore të piramidës së nevojave sipas Makiavelit. Kurani Fisnik na pasqyron qartë udhëtimin e tyre evolutiv me theksin në nxitjet universale dhe mënyrën e tejkalimit të tyre. ■



KA VËSHTIRËSI SOCIALE DHE MENDON TA HEQ HIXHABIN...

MUHAMED IBËN SALIH MUNEXHID

Pyetja: Punoj si drejtoreshë sektori në një ministri. Unë i takoj një familjeje me famë dhe autoritet. Ndjem tejet e huaj

në shoqërinë ku jetoj. Urrej ndejat dhe tubimet me gjini të përziera dhe mosinteresimin e shoqërisë për fenë. E dua hixhabin, lexoj Kuranin... nuk jam e martuar, sepse ata që më kanë propozuar nuk ishin të kapur mirë për fenë. Kam

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

shkuar në Umre dhe jam kënaqur duke u falur në Reuda, jam kënaqur me atë shoqëri të mbrojtur nga kulturat e huaja. Jam kënaqur duke mbajtur ferexhenë, sepse nuk mund ta mbaj në vendin tim, ishte një kënaqësi e rrallë. Ato ishin ditët e mia më të lumtura. Tani ndiej se imani po më dobësohet. Kam filluar ta lë namazin për shkak vështirësisë për të marrë abdes në punë dhe për shkak të kohës, kam hequr hixhabin... jeta më është bërë e hidhur, ju lutem më ndihmoni, më këshilloni!

Përgjigje: Falënderimi i takon Allahut...

Së pari: Ne e vlerësojmë drejt madhësinë e problemit nga i cili ti po vuan. Po ashtu e vlerësojmë drejt intensitetin e presioneve që të bëhen për të braktisur fenë dhe praktikimin e saj. Këto probleme nuk i ke vetëm ti, porse me mijëra muslimanë të tjerë, të cilët dëshirojnë t'u përmbahen ligjeve të kësaj feje, duan të jetojnë me nder, pastërti e moral dhe përballen me vështirësi të ndryshme nëpër shoqëri të cilat fatkeqësisht kanë devijuar nga Islami dhe çdonjërin që kapet pas kësaj feje e shikojnë me syrin e nënçmimit... lusim Allahun që të ndihmojë fenë e Tij dhe besimtarët e drejtë!

Së dyti: *“Dije se malli i Allahut është i shtrenjtë, dije se malli i Allahut është xheneti”* kështu ka thënë i Dërguari i Allahut. S'ka mëdyshje se malli i shtrenjtë edhe çmimin e ka të madh. Nuk ka asgjë më të shtrenjtë se xheneti, prandaj muslimani duhet që ta bindë veten, se çdo vështirësi që do të hasë në rrugën e tij për xhenet do ta përballojë dhe sado e madhe që të jetë vështirësia, nuk mund të krahasohet aspak me të mirat që e presin në xhenet. Kjo bindje ia lehtëson njeriut brengat e kësaj bote dhe vështirësitë, të

cilat ai i has në rrugën e tij për tek Allahu.

I Dërguari na ka treguar, se *“njeriu i cili ka përjetuar të këqijat më të mëdha në këtë botë – që do jetë prej banorëve të xhenetit – ditën e Ahiretit Allahu vetëm një herë do ta zhysë në xhenet dhe do ta nxjerr pastaj do ta pyesë: O biri Ademit, a ke parë ndonjëherë vështirësi? A ke kaluar ndonjë moment të keq? Ai do të përgjigjet: Jo, pasha Allahun, o Zoti im, asnjë e keqe nuk më ka ndodhur, asnjë të keqe nuk kam parë.”* (Muslimi)

Njeriu sado të këqija, sprova e vështirësi që mund t'i paramendojë rreth tyre, ashtu siç ka thënë i Dërguari *“njeriu që ka përjetuar vështirësitë më të mëdha”* me një zhytje në xhenet do t'i harrojë të gjitha.

I Dërguari po ashtu na ka lajmëruar për ditët që kanë nevojë për durim. Ai që do të mbajë fenë në ato ditë do të jetë sikurse ai që mban në dorë prushin. Ndoshta ka pasur si qëllim këtë kohë, prandaj duhet të durojmë patjetër, t'i mbajmë vështirësitë sado të mëdha që janë, të përballemi me to, në të kundërtën, do të humbin dynjanë dhe Ahiretin: ***“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.”*** (sure Asër)

Së treti: duke pasur parasysh presionet sociale dhe politike, të cilat ne i vlerësojmë drejt, po të dhurojmë disa këshilla ty dhe gjithë atyre që kanë të njëjtin problem, duke iu tërhequr vërejtjen se në rrethana të tilla duhet të pajtohemi patjetër me alternativën “zgjidhje gjysmake dhe praktikim i pjesshëm”, që të mos lihet feja në tërësi, me kusht që vazhdimisht të kërkojmë më të mirën dhe të punojmë për t'i tejkaluar

vështirësitë me tërë qenien tonë dhe në mënyrë graduale të ngjitemi drejt përsosmërisë.

Këto “zgjidhje gjysmake” paraqesin një fazë të përkohshme e jo të vazhdueshme. Atë që në këtë kohë nuk mund ta bëjë muslimani në tërësi për shkak të presioneve le ta bëjë me aq sa mundet derisa të eci dalëngadalë drejt të plotës dhe ta pranojë shoqëria ndryshimin prej një gjendjeje në një tjetër. Kjo është më e lehtë se të ballafaqohesh me probleme për të cilat nuk ke fuqi. Më poshtë do të përmendim disa këshilla – dhe kërkojmë falje që u zgjatëm – mirëpo çështja është tejet e rëndësishme dhe kanë nevojë për të me mijëra muslimanë, prandaj nuk mjaftojnë dy apo tri fjalë:

“La haule ue la kuvete il-la bil-lah” Është kjo një fjalë e bukur, një prej thesareve të xhenetit kuptimi i së cilës është: nuk kemi fuqi për t’u ndryshuar prej një gjendjeje në një tjetër, prej mëkatit në bindje ndaj Zotit, prej të keqes tek më e mira përpos se me ndihmën e Allahut dhe përkrahjen e Tij. Ne duhet të kërkojmë patjetër ndihmën e Allahut në fillim dhe në mbarim. Në suren Fatiha, të cilën muslimani e lexon çdo ditë disa herë, thuhet: **“Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**. Allahun nuk mund ta adhurojmë nëse Ai nuk na udhëzon drejt atij qëllimi dhe na ndihmon. Prej lutjeve që do të bëjnë banorët e xhenetit është: **“Falënderojmë Allahun që na udhëzoi për këtë** (për iman, për punë të mira, na e hoqi zilinë, na futi në xhenet), **pse sikur të mos na drejtonte Allahu, ne nuk do të dinim të udhëzohemi.”** (Araf: 43). Pra, patjetër të kërkojmë ndihmën e Allahut, të mbështetemi në Të dhe të vetëdijesohemi se gjërat janë në dorën e Tij. Vetëm me fjalën “bëhu” Ai bën gjithçka. Kërkoji

ndihmë Allahut, dorëzoja çështjen Atij dhe ki besim se zgjidhja vjen prej Allahut: **“Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij.”** (Talak: 3).

Shpeshtoj lutjet që Allahu të ta lehtësojë punën tënde, të të udhëzojë drejt çdo të mire, të të inspirojë të drejtën, të të mbrojë nga çdo e keqe, duke pasur parasysh fjalën e Omer ibën Hatabit: “Unë nuk preokupohem a do më pranohet lutja apo jo, unë preokupohem të bëj lutje. Nëse inspirohesh të bësh lutje, me të është edhe pranimi i saj.”, me lutje largohen pikëllimet dhe mënjanoen brengat. I Dërguari thotë: *“Çdo musliman që bën një lutje në të cilën nuk ka mëkat apo dëmtim të lidhjeve farefisnore, fiton njërën prej tre gjërave: ose i pranohet lutja, ose i depozitohet shpërblimi i saj për në Ahiret, ose do t’i largohet për shkak të saj një e keqe.* Shokët e tij thanë: Atëherë a të bëjmë shumë lutje?! *Allahu ka më shumë – u përgjigj ai.”* (Ahmedi- Sahih Tergib)

Adhurimet, në veçanti namazin: kushtoj rëndësi të madhe adhurimeve, sepse ato e ngjallin zemrën, e kthjellin të pavëmendshmin, janë prej faktorëve kryesorë të stabilitetit dhe ecjes në rrugë të drejtë pas udhëzimit të Allahut. Adhurimi më madhështor është namazi. Ai është shtylla kryesore e fesë pas dëshmisë. Zemrat pa namaz nuk kanë jetë. Namazi të rehaton nga çdo brengë e vështirësi dhe për këtë arsye i Dërguari i thoshte shpesh Bilalit: *“Na rehato me të* (d.m.th. thirrë ezanin për namaz), *o Bilal.”* (Sahih Ebu Davud). Falu, frikësohu prej Allahut, medito, qaj dhe largoji brengat e kësaj dynjaje dhe lodhjeve të saj.

Leximi i Kuranit Famëlartë: Kujdesu të lexosh sa më shumë nga Kurani Famëlartë. Duhet të caktosh për çdo ditë nga një fragment që do ta lexosh. Këtë mos e le. Mundohu që të kesh ndonjë komentim të

shkurtër, që do të ndihmojë për kuptimin e ajeteve siç është Tefsiri i Sadit apo Ejseru Tefasir të dijetarit Ebu Bekër Xhezairi. S'ka fjalë më madhështore se fjalët e Allahut, ashtu siç nuk ka këshillë më të mrekullueshme se këshillat e Allahut. S'ka libër në të cilin mund të gjesh udhëzimin, sqarimin, rrugën e drejtë, largimin e brengave e pikëllimeve sikurse Kurani.

Dhikri dhe lutjet: Bëje vazhdimisht dhikrin e transmetuar nga i Dërguari për raste të ndryshme, siç është dhikri i mëngjesit dhe i mbrëmjes, kur fle apo zgjohesh prej gjumit, kur ha dhe pi, kur del prej shtëpisë dhe kur hyn... dhe në të gjitha rastet duke i vendosur theks të veçantë kuptimit të dhikrit që ti bën. Prej librave më të mirë në këtë fushë është "Futuhat rabbaniye bishersh el-Edhkar Nevevije" të Ibën Alanit. Është një libër i vlefshëm, që të mundëson të mëson kuptimin e dhikreve, sepse kjo ta lehtëson meditimin, ta ngjall zemrën dhe të lidh me të Gjithëdijshtin.

Dëgjimi i ligjëratave dhe hutbeve të dobishme: vazhdo të dëgjosh ligjëratat fetare dhe hutbe, ngase njeriu ka nevojë vazhdimisht të përkujtohet, të udhëzohet e të këshillohet. Nëpërmjet këtyre ligjëratave njeriu mëson shumë dispozita të fesë së vet, e pastaj do të dijë si të sillet në raste të ndryshme.

Leximi dhe studimi: duhet të lexosh dhe të studiosh patjetër çështjet e fesë, ngase "*kujt ia do Allahu të mirën e bën të kuptojë fenë*" (Buhariu dhe Muslimi). Shumë punë që duken të vështira e të komplikuar, sikur njeriu t'i kishte

studiuar apo të pyeste dijetarët do të lehtësoheshin. Mundet që të ketë lehtësime, të cilat nuk i di, apo të ketë ndonjë zgjidhje tjetër që e ofron sheriatit dhe kështu lehtësohen gjërat. Prej librave të dobishme që ju këshillojmë t'i lexoni janë: Fikhu Suneh i dijetarit Sejid Sabik, Mulahas Fikhij (Fikhu shkurtimisht) i dijetarit Salih el-Feuzan² dhe Audetul Hixhab (Kthimi i Hixhabit) i dijetarit Muhamed ibën Ismail. Një mundësi tjetër për të mësuar janë faqet e dobishme të internetit.³ Duhet të lexosh edhe në lëmin e Historisë bashkëkohore, sidomos ajo pjesë që ka të bëjë me vendin tënd, si është luftuar Islami? Cilat kanë qenë kurthet e tyre? Njohja e këtyre gjërave e ngjall shpirtin sfidues dhe të bën më të përkushtuar ndaj fesë tënde.

Për sa i përket hixhabit dhe pamundësisë për ta mbajtur sërish themi se ne e kuptojmë sa e madhe është lufta kundër hixhabit e që ju ballafaqoheni çdo ditë⁴, prandaj mendojmë se s'prish punë që për shkak të atyre rrethanave të veçanta hixhabin ta aplikosh gradualisht. Atë që prindërit apo shoqëria nuk e pranon sot mund ta pranojnë gradualisht pas një muaji, dy apo pas një viti. Sa të kesh mundësi vish rroba të përshtatshme, të mundohesh maksimalisht të mbulosh kokën, rrobat të jenë të gjera, pak nga pak derisa të normalizohet te njerëzit e ti të bësh hapin tjetër, kështu gjersa të arrish te hixhabi i plotë, të cilin Allahu ua bëri obligim besimtareve, atë hixhab të cilin ti e dëshiron dhe je e kënaqur me të në vendin e Dy Haremeve kur ke qenë aty. Mirëpo mos shpejto, pak nga pak do të

¹ Në gjuhën shqipe kemi të përkthyerat librat "Mburoja e muslimanit" "Fikhu i lutjeve dhe i dhikrit".

² Këto dy libra janë të përkthyerat në gjuhën shqipe.

³ Prej faqeve të dobishme ju preferojmë: www.albislam.com dhe www.qsi-ks.com

⁴ Dijetari flet për ato vende ku mbajtja e hixhabit ndalohet nga regjimet diktatoriale që dominojnë.

arrish atë që dëshiron me lejen e Allahut. Kjo nuk është metoda më shembullore që duhet të ndjekë muslimani, mirëpo është e pranuar në raste të patjetërsuara, në rrethana të veçanta sikurse ato të tuat, prandaj arritja e disa gjërave është më e mirë se asgjë dhe arritja deri tek e përsosura dalëngadalë është më e mirë, se humbja e gjithçkaje.

Për sa i përket namazit dije se ai është shtylla më e rëndësishme e Islamit pas shehadetit. Është lidhja jote me Zotin, për këtë duhet që t'i kushtosh rëndësi të madhe. Duhet të kujdesesh ta falësh në kohë ***"namazi është obligim (për kohë) i caktuar për besimtarët."*** (Nisa: 103). Një herë mundohu të marrësh abdes në një vend ku nuk ka burra të huaj, nëse nuk të mundësohet atëherë mund që të futesh në nevojtoare (aty ku kryhet nevoja), sepse abdesi mund të merret edhe aty. Pastaj në namaz duhet të mbulosh tërë trupin përpos fytyrës dhe duarve, nëse këtë nuk mund ta bësh, atëherë në zyrën tënde duhet të kesh rroba të veçanta, sa për të kryer namazin. Besojmë se për namazet e sabahit, akshamit dhe jacisë nuk ka problem, sepse koha e tyre është pasi të mbarojë orari i punës, prandaj nuk ka arsye të pranuar për vonimin e këtyre namazeve, pra kujdesu më tërë qenien që t'i falësh në kohët e tyre. Për sa i përket namazit të drekës, ikindisë dhe akshamit gjatë dimrit, në esencë duhet të falen në kohët e tyre, duhet të kërkosh mënyra dhe hile për t'u falur, mirëpo nëse nuk mundesh assesi, atëherë shpresojmë të kesh arsye për të vonuar drekën deri para perëndimit të diellit. Asnjë arsye nuk pranohet për t'i vonuar deri pas perëndimit të diellit. Sa i takon namazit të akshamit gjatë dimrit, nëse mund të falesh në punë kjo është detyrë, nëse nuk mundesh atëherë e vonon deri në kohën e

jacisë dhe e fal së bashku me jacinë kur të kthehesh në shtëpi. Më këtë ty nuk të ka ikur koha, që është kusht i namazit, sepse për nevoja të domosdoshme lejohet ky bashkim në mënyrën që e sqarova.

Në fund ta bëjmë me dije se shumë probleme të cilat i ke me namazin e hixhabin janë për shkak të punës në një vend ku gjinitë janë të përziera. Puna e një muslimaneje në këso vendesh, pa rregulla të sheriatit shpien drejt shumë dëmeve, që ti i di mirë, prandaj sheriat i ndalon punën në vendet e përziera. Nëse mund të transferohesh në ndonjë sektor tjetër, apo në ndonjë punë tjetër, larg burrave të huaj kjo do t'i zgjidhte shumë probleme, apo edhe nëse vendos të braktisë punën përpos nëse ke presione prej familjes për të vazhduar, atëherë shpresojmë të kesh një arsye për të mbetur aty, duke u kujdesuar dhe duke u ruajtur nga dëmet me aq sa ke mundësi.

Lusim Allahun të të forcojë, të të udhëzojë kah hairi, të të mbrojë nga e keqja dhe të të furnizojë me pasardhës të mirë, se me të vërtetë Allahu është Udhëzuesi drejt rrugës së vërtetë! ■

Përktheu: Agim Bekiri



REPUBLIKA E TUNIZISË

SHKRUAN: DRITON LEKAJ

Sikundër se Burgiba edhe pasardhësi i tij Ben Ali ishte një fytyrë ushtarake dhe ushtroi një pushtet të hekurt mbi të gjitha nyjat e shtetit për vite të tëra. Edhe pse në Tunizi sistemi demokratik është shumëpartiak, partia në pushtet Partia Kushtetuese Demokratike (RCD) ka kontrolluar vendin si një nga regjimet më represive në botën arabe

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Emri i plotë: Republika e Tunizisë

Kryeqyteti: Tunizi

Sipërfaqja: 163,610 km².

Banorët deri më 2009: 10,432,500

Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005): 1.1 %

Përqindja e muslimanëve: 98 %.


Gjuha: Árabe.

Monedha: Dinari Tunizian (TND)

Pavarësia: 20 Mars 1956 (nga Francëzët)

Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 12 Nëntor 1956

Anëtar i Konferencës Islamike: 1969



Ana Gjeografike¹:

Është vendi më verior i Afrikës. Është një ndër vendet e Magribit Arab. Në përfundim kufizohet me Algjerinë, në juglindje përkufizohet me Libinë, ndërsa me Detin Mesdhe në veri dhe në lindje. Tunizia është vendi më i vogël, i cili shtrihet përgjatë vargmaleve “Atlas”. Jugu i vendit përbëhet nga shkretëtira ‘Sahara e madhe’², e cila arrin përafërsisht në 30%, ndërsa pjesa e mbetur është tokë pjellore. Kryeqyteti i saj është Tunizi, ndërsa emri i saj zyrtar është Republika e Tunizisë.

Ana Historike:

Tunizia është çliruar në vitin 27H/647G., në kohën e sundimit të Osmanit (Allahu qoftë i kënaqur me të) dhe kjo ka ndodhur nën komandën e Abdullah ibën Sad Ibën Ebu Rebahut. Emevitë i vazhduan çlirimet nën komandën e Ukbe ibën Nafiut në vitin 50H/670G. Më pas gjatë dinastisë së Abasitëve, në vitin 800 u themelua shteti i Aglebidëve, i cili u shua në vitin 296H/908G. Pas tij, Tunizia u sundua nga shtete të ndryshme njëri pas tjetrit, gjersa u pushtua nga Perandoria Osmane në vitin 1573, pastaj nga shteti i Bajatve në 1705. Në vitin 1881 Franca e kolonizoi Tunizinë dhe e futi nën protektoratin e vet gjersa më: 20.03.1956 e fitoi pavarësinë e saj nga Franca. Këtë protektorat Franca e arriti përkundër ambicieve të Italisë. Franca ushtroi ndikim të drejtpërdrejtë, si në

“Gruaja e tij, e cila me vite kishte diktuar ushtrimin e dhunës ndaj grave që dëshironin ta praktikojnë urdhrin për shaminë, është urdhëruar që nëse dëshiron të dalë për shopping të vishet sipas modelit të veshjes islame...”

rritjen e kolonizatorëve ashtu edhe në rrafshet e tjera, saqë gjuha frënge është gjuha e dytë dhe ka ndikim të madh edhe në regjistrin e gjuhës që flet populli.³

Ana politike:

Tunizia e udhëhequr nga Habib Burgiba e arriti pavarësinë nga Franca dhe Burgiba më vonë u bë kryetari i parë tunizian. Në nëntor të vitit 1987 mjekët deklaruan se ai ishte i papërshtatshëm për të qeverisur kësaj me një grusht shteti ‘të ftohtë’, kryeministri **Zine El-Abidine Ben Ali** mori presidencën. Tunizia është një republikë kushtetuese, me një president që shërben si shef i shtetit, kryeministri si kryetar i qeverisë, një legjislaturë dydhomëshe dhe një sistem gjyqësor i ndikuar nga kodi civil francez. Së bashku me kodin civil francez ka qenë në zbatim edhe Kodi i Statusit Personal i mbështetur në Fikhun Islam, por

¹ <http://en.wikipedia.org/wiki/Tunisia>

² Sahara (Es-Sahra El-Kubra, ar.): është shkretëtira e cila përfshin sipërfaqen më të madhe veriore të kontinentit afrikan. Ajo është shkretëtira më e madhe në botë dhe sipërfaqja e saj kalon 9.000.000 km². Sahara dallohet për vargun e shpeshtë të oazeve dhe fushave të naftës. Në këtë shkretëtim gjenden gjithashtu edhe vargmalet e larta “Atlas”. Sahara shtrihet në 12 shtete të ndryshme mes tyre edhe Algjeria, Libia, Egjipti, Maroku etj. http://en.wikipedia.org/wiki/Sahara_desert.

³ Marrë në përgjithësi nga libri: “Atlas i Shteteve të Botës Islame” të Dr.Shevki Ebu Halil.

që jo më pak se pesë muaj pas pavarësisë është modifikuar vazhdimisht, që të mundësojë modernizimin e shoqërisë - sipas pretendimeve të tyre - ku është anuluar praktika e poligamisë dhe mundësisë së divorcit njëanshmërisht nga ana e burrit.

Realiteti bashkëkohor tunizian:

Sikundër se Burgiba edhe pasardhësi i tij Ben Ali ishte një fytyrë ushtarake dhe ushtroi një pushtet të hekurt mbi të gjitha nyjat e shtetit për vite të tëra. Edhe pse në Tunizi sistemi demokratik është shumëpartiak, partia në pushtet Partia Kushtetuese Demokratike (RCD) ka kontrolluar vendin si një nga regjimet më represive në botën arabe, që nga pavarësia e saj më 1956. Sa herë që zgjidhej Ben Aliu ai merrte një numër shumë të madh votash dhe herën e fundit që ka ndodhur kjo është më 25 Tetor 2009.

Ky është modernizimi i trumbetuar nga Ben Ali për popullin e vet e që në fakt ishte një robërim 'modern' i një populli të etur për liri nga shtypja dhe kolonializmi, i etur për të gëzuar të drejtat esenciale nga të cilat ishin privuar shekujt e fundit.

Mjafton të ndalemi tek raportet e organizatave të pavarura për të drejtat e njeriut, si Amnesty International e të tjera, që kanë raportuar se të drejtat themelore dhe politike të njeriut nuk janë respektuar. Ndërsa revista 'The Economist' në 'Indeksin e Demokracisë' të publikuar në vitin 2008 e kishte klasifikuar si një nga regjimet më autoritare, duke e renditur të 141 nga 167 vende të studiuara.

Korrupsioni familjar

Regjimi i Ben Alisë është akuzuar vazhdimisht për nepotizëm dhe

“Ministri i Brendshëm shkoi aq larg, saqë deshi që atyre që shkojnë në namazet ditore në xhami t’ju japë karta elektronike, në mënyrë që të lehtësohej spiunimi ...”

korrupsion familjar, ku janë akuzuar për një kontroll maksimal të biznesit në vend. Për këtë lloj akuze është theksuar vazhdimisht familja Tarabulsi – familja e gruas së dytë të Ben Alisë, e cila udhëhiqte reformimin dhe modernizimin e vendit – siç pretendonin ata. Ajo udhëtonte nëpër kryeqendrat evropiane të modës si Milano, Parisi dhe Gjeneva me aeroplanët zyrtarë në vizita 'jozyrtare'. Se sa ndikim të madh kishte për të ushtruar duke qenë zonja e parë mundet ta paramendojmë se çfarë 'modernizimi' do të përjetonte populli tunizian, nëse do ta merrte ajo pushtetin, që e kishte planifikuar sipas disa raporteve mediatike.

Rrëzimi i diktatorit:

Për rrëfimin e rrëzimit të diktatorit kemi dëgjuar dhe lexuar shumë ditëve të fundit, por mjafton të përmendet që një shitës ambulant, me emrin Muhamed Buaziz, të cilin si dhe shumë moshatarë të tjerë, skamja dhe papunësia e kishin detyruar të dilte e të punonte në rrugë, me gjithë kualifikimin e tij superior mënyra se si ai e shprehu mllefin e tij për krenarinë e cenuar ndezi mllefin e mbarë popullit tunizian, dhe i treguan diktatorit e mbarë botës se nëpërkëmbja e popullit, megjithatë ka një kufi. Prandaj jo vetëm që e arritën lirinë e tyre, por jehona e

qëndresës së tyre u dha shpresë shumë popujve të botës dhe bëri që në shumë vende të rishikohej marrëdhënia mes udhëheqjes dhe popullit.⁴

Ben Ali edhe pse mori ndëshkimin e popullit më 14 Janar 2011, kur u detyrua i turpëruar ta lëshonte vendin e tij, në errësirën e natës ashtu siç bëjnë hajdutët dhe kriminelët, por edhe pse doli me ndihmën e miqve të tij libianë dhe francezë ata nuk deshën që ai të shkelte tokën e tyre. Një njeri që e refuzon toka e vet herët a vonë nuk do të ketë tokë, e cila do ta shpëtojë nga dënimi i merituar.

Vendimi i Arabisë Saudite për pranimin e tij, edhe pse i diskutuar, përbën në vetvete një simbolikë të veçantë. Ben Aliut në Arabinë Saudite i është ndaluar ushtrimi i aktivitetit politik dhe gruaja e tij, e cila me vite kishte diktuar ushtrimin e dhunës ndaj grave që dëshironin ta praktikojnë urdhrin për shaminë, është urdhëruar që nëse dëshiron të dalë për shopping të vishet sipas modelit të veshjes islame, që automatikisht do të thotë ta vendosë shaminë.

Me të vërtetë njeriu shtanget kur kujton atë epokë të errët nëpër të cilën ka kaluar populli tunizian, e që do të qartësohet edhe më kur të flasim për të drejtat dhe liritë fetare.

Jeta fetare në Tunizi: të drejtat⁵ dhe lëvizjet fetare⁶.

Represioni i aparatit shtetëror ndaj të drejtave dhe lirive fetare ishte ndër më të tmerrshmit dhe më të guximshmit ndër diktaturat në Lindjen e Mesme. Kjo daton herët, apo e thënë më mirë që nga pavarësia e fituar nga Franca. Habib

Burgiba kryetari i atëhershëm kishte ndërmarrë disa hapa në këtë drejtim:

Anulimi i agjërimit për punëtorët, ngase e zbeh produktivitetin e tyre dhe ndikon në prodhim.

Largimi i shamisë, ngase e pengon zhvillimin.

Gjithashtu ai përmes shërbimit sekret i shqetësonte njerëzit që falnin namazin me xhemat e sidomos të rinjtë.

Shkoi edhe më larg duke pretenduar, se Kurani ka kundërthënie dhe përmban legjenda etj. Për këtë dijetarët si: AbdulAziz ibën Baz (Myfti i Arabisë Saudite), Ebul Hasen En-Nedeviu (Sekretar i Dijetarëve të Indisë), Hasenejn Mahluf (Myfti i Egjiptit), Ebu Bekr Xhumi (Kryetar i kadive në Nigeri) dhe Muhamed Emin Misriu e thirrën në një shkresë të tyre të pendohet dhe të kthehet në Islam, përndryshe kjo llogaritet si kufër i qartë etj. Megjithatë kjo nuk ndikoi që ai të ndryshonte mendimin e tij.

Ky realitet i hidhur vetëm sa u vështirësua me ardhjen e Ben Alisë në pushtet në vitin 1987.

Ai e intensifikoi 'luftën ndaj shamisë', duke ndaluar femrat me shami të marrin pjesë në shkollimin parauniversitar dhe atë universitar.

Burgosja e mijëra njerëzve për shkak të dashamirësisë së tyre ndaj fesë.

Standardet e dyfishta, duke i lejuar ateistët dhe dyfytirëshat të shkretojnë dhe të ofendojnë islamin, ndërsa muslimanët nuk mund t'iu kundërpërgjigjen atyre.

Ministri i Brendshëm shkoi aq larg, sa që deshi që atyre që shkojnë në namazet ditore në xhami t'ju japë karta elektronike, në mënyrë që të lehtësohej spiunimi i tyre

⁵ <http://www.islamlight.net/index.php?option=content&task=view&id=3309>

⁶ <http://www.alarabiya.net/articles/2011/01/19/134222.html>

⁷ Kështu e emërtoi ai në një fjalim të mbajtur në vitin 2006. <http://en.wikipedia.org/wiki/Tunisia#Religion>]

dhe të terrorizohen edhe më shumë.

Kjo është një pasqyrë e shkurtër, por e dhimbshme për atë që ka ndodhur në një shtet, që sipas kushtetutës e ka Islamin fe zyrtare dhe Presidenti duhet të jetë musliman.

Lëvizjet fetare në Tunizi:

Lëvizja “Nehda” (Rigjallërimi): Është lëvizja më e njohur dhe më e madhja në Tunizi. Programi i saj mbështetet në rikthimin në jetë të rolit të xhamisë, mbështetet në universalitetin e Islamit dhe parimin e Shuras për zgjidhjen e çështjeve politike dhe kulturore.

Selefinjtë: Është ndër lëvizjet me zhvillimin më të hovshëm, por në heshtje. Kryesisht janë të përqendruar në arsimimin dhe edukimin fetar dhe në këtë ndikim të madh kanë edhe kanalet satelitore në shtetet e rajonit dhe internetit.

Hizb Et-Tahrir: Nuk dihet saktësisht ndikimi i tij, ngase anëtarët e tij mbështeten në aktivitete sekrete, por përmes shfletimit të parimeve të partisë synojnë ngritjen e kalifatit islam përmes ndryshimit radikal, qoftë edhe përmes revolucionit, deri sa të arrijnë të ndryshimi i simeve diktatoriale.

Xhemati Teblig: Është futur në Tunizi nga mesi i viteve shtatëdhjetë shekulli i kaluar, por edhe pse shteti i pati toleruar megjithatë kanë qenë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të tij.

Shiat: Edhe pse në numër të vogël ata zhvillojnë aktivitetin e tyre në Tunizi, i cili tradicionalisht është shtet sunit. Si edhe në shtetet e tjera mashtrimi pas ideve të shiizmit erdhi si pasojë e mashtrimit që u sajoi muslimanëve revolucionin iranian, që e

prezantoi veten si revolucion islamik. Megjithatë lëvizjet islame në tërësi janë kundër kësaj lëvizjeje dhe ideve të cilat i plason ajo.

Ana Ekonomike:

Tunizi ka një ekonomi të ndryshme, duke filluar që nga bujqësia, minierat, prodhimi dhe produktet e naftës, e deri te turizmi. Edhe pse Tunizia ka pasur një rritje mesatare prej 5% gjatë dekadës së fundit ajo vazhdon të vuajë nga një papunësi e lartë veçanërisht të rinjtë.

Në vitin 2009 Tunizia u rendit ndër ekonomitë më konkurruese në Afrikë dhe e 40-ta në botë, nga ana e Forumit Ekonomik Botëror. Tunizia ka arritur të tërheqë shumë kompani ndërkombëtare të tilla si Airbus dhe Hewlett-Packard. Bashkimi Evropian mbetet partneri i parë tregtar i Tunizisë. Aktualisht sipas përllogaritjeve Tunizia shkëmben me BE -në: 72,5% të importeve tuniziane dhe 75% të eksporteve tuniziane.

Tunizia gjithashtu ka tërhequr investime të mëdha nga shtetet e Gjirit Persik, sidomos nga Emiratet e Bashkuara Arabe. Ndër projektet më të mëdha janë:

Porta e Mesdheut (Mediterrane Gate): Një qytet i ri tërësisht me kosto rreth 20 miliardë \$.

Qyteti Sportiv i Tunizisë: Me kosto prej 5 miliardë \$.

Qyteti Tunizian i Telekomit: me një investim prej 3 miliardë \$⁸. ■

⁸ <http://en.wikipedia.org/wiki/Tunisia>